



TEB Sh.A RAPORTI VJETOR 2011

BANKË PËR NJË BOTË NË LËVIZJE



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

HYRJA 3-4

Deklarata e Bordit të Drejtorëve rreth raportit vjetor	5
Profili i korporatës	7
Misioni ynë, vizioni dhe strategjia	8
Shtyllat kryesore të strategjisë dhe vlerat tona themelore	9-10
Struktura e aksionarëve	11-12
Vështrimi makroekonomik	13-14
Letër nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve	15-16
Letër nga Kryesuesi Ekzekutiv (CEO)	17-20

TEB-i NË VITIN 2011 21-22

TEB në shifra	23-25
Treguesit kryesorë financiarë	26
Shërbimi bankar për individë	27-30
Shërbimi bankar për NVM (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme)	31-32
Shërbimi bankar për biznese dhe korporata	33-34
Menaxhimi i parasë dhe pagesat	35-36
Biznesi i kartelave dhe qendra e thirrjeve	37-38
Financat tregtare	39-40
Thesari	41-42
Burimet njerëzore	43-44
Teknologjia informative	45-46

MENAXHMENTI 49-50

Bordi i Drejtorëve	51-54
Komitetet	55-56
Auditimi i brendshëm, kontrolli i brendshëm, menaxhimi i rrezikut	57-60
Pajtueshmëria ligjore dhe bankare	61-62

INFORMACIONET FINANCIARE 63

Raporti i pavarur i auditimit për datën 31 dhjetor 2011 dhe shënimet rreth llogarive financiare

UDHËZUESI



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Ne punojmë për klientët tanë dhe ambiciet e tyre për të ardhme më të mirë.

Ne inkurajojmë klientët tanë në përpjekjet e tyre dhe i mbështesim ata me të gjitha mundësitë që i kemi në dispozicion. Banka nuk e ndryshon botën, njerëzit e bëjnë atë. Kjo është arsyeja se pse ne duam t'i shërbejmë klientët në mënyrën më të mirë të mundur. Suksesin tonë më së miri mund ta vlerësojmë duke ditur se sa kemi qenë në gjendje t'i ndihmojmë klientët në arritjen e qëllimeve të tyre dhe besojmë se këtë mund ta bëjmë duke iu ofruar atyre shërbimet më të mira dhe më kualitative të mundshme.

Ne kuptojmë se secili nga ne duhet të jep kontributin e tij për ta dërguar botën përpara, kështu që le të mundohemi, le të vazhdojmë të ëndërrojmë dhe le të vazhdojmë të arrijmë.

Çdo ditë përmban sfida dhe premtime që duhet të arrihen.

Ne lëvizim bashkë me klientët tanë që ta dërgojmë botën përpara.

Ne e përpiluar Raportin Vjetor 2011 rreth "Lëvizjes", duke synuar që të përshkruajmë përpjekjet tona të thella për t'u zhvilluar, duke lëvizur vazhdimisht përpara.

"Nëse jemi në rrugën e duhur, krejt çka duhet të bëjmë është të vazhdojmë tutje".





Ne vazhdojmë të lëvizim përpara, të hapim dyer të reja dhe të bëjmë gjëra të reja, sepse jemi kureshtarë dhe kureshtja vazhdon të na dërgojë drejt shtigjeve të reja.

Walt Disney

DEKLARATË PËR RAPORTIN VJETOR 2011 TË TEB Sh.A

Raporti Vjetor i TEB Sh.A ka qenë i përgatitur në përputhje me **“Ndryshimin e Rregullores XI – Raportimi i bankave dhe degëve të bankave të huaja në Kosovë të autorizuar sipas nenit 36 të rregulloreve të UNMIK-ut”, të vitit 1999.**

Musa Erden

Kryetari i Bordit
të Drejtorëve



Ayşe Aşardağ

Anëtare e Bordit të Drejtorëve
Kryetare e Komisionit për Auditim



Didier A.N Van Hecke

Anëtar i Bordit të Drejtorëve
Nënkryetar i Komisionit për Auditim



Dr. İsmail Yanık

Nënkryetar i Bordit
të Drejtorëve
Kryetar i Komitetit ALM



Alp Yılmaz

Anëtar i Bordit të Drejtorëve
Kryesues Ekzekutiv (CEO)



Nagip Krasniqi

Kryesues i Financave
(CFO)





TEB synon të japë rezultatet më të mira për klientët e saj nëpërmjet zgjidhjeve financiare që janë **kreative dhe të përgjegjshme**.

TEB operon në bazë të parimeve të përcaktuara qartë. Vlerat e korporatës janë nxjerrë nga këto parime të bazuara në **përgjegjësinë për shoqërinë** si tërësi dhe për **mjedisin**.

TEB ka krijuar tashmë një reputacion të **besueshmërisë, udhëheqësisë dhe risive** - këto vlera janë pasqyruar në të gjitha aktivitetet tona.

Në vitin 2005, TEB A.Ş. ka hyrë në një ndërmarrje të përbashkët me BNP Paribas. **BNP Paribas** është një nga pesë bankat më të forta në botë dhe banka më e madhe në eurozonë. Një lider në ofrimin e shërbimeve bankare dhe financiare, ajo ka një shtrirje globale me aktivitete të forta tregtare bankare dhe aktivitete të korporatave. BNP Paribas është shumë e pranishme në të gjitha tregjet e mëdha financiare: Nju-Jork, Londër, Hong Kong dhe Paris. BNP Paribas ka një nga rrjetet më të mëdha ndërkombëtare që operojnë në më shumë se 85 shtete, duke punësuar më shumë se 200,000 bankierë profesionistë në mbarë botën. **Turk Ekonomi Bankasi A.Ş. (TEB)** është ndër aktorët më të vjetër dhe më me reputacion në sektorin financiar turk. I themeluar në vitin 1927, ajo ka ndërtuar 84 vjet njohuri dhe ekspertizë në sektorin bankar. TEB sot vazhdon të jetë një nga bankat më të forta në Turqi.

Pas bashkimit, grupi filloi të rritet me shpejtësi në tregun turk. Dega e parë e dalë nga ndërmarrja e përbashkët ishte në Kosovë dhe TEB Sh.A hyri në tregun e Kosovës në vitin 2008.

Mbështetur nga përvoja globale në fushën e bankave të këtyre dy grupeve të forta, TEB Sh.A shpejt ka demonstruar **aftësinë tonë për t'u përshtatur me shpejtësi në tregun vendor bankar**. Ne jemi duke bërë përparim të madh në misionin tonë për ta sjellë në Kosovë kulturën e kombinuar të BNP Paribas dhe të TEB-it.

Përveç operacioneve kryesore bankare, TEB Sh.A ofron një gamë të gjerë të shërbimeve bankare dhe financimin e tregut të jashtëm. **Ne veprojmë në çdo segment të sektorit bankar me:** Korporata, Tregti, *NVM dhe Shërbime Bankare për Individë.

Duke siguruar **produkte të reja e praktike dhe shërbime**, ne dallojmë me aktivitetet tona në treg nëpërmjet përqendrimit të konsumatorët, të nxitura nga një model dinamik i biznesit dhe me një infrastrukturë të përparuar teknologjike.

Pas vetëm katër vjet pune në Kosovë, në vitin 2011 ne kemi arritur 11% të tregut sa i përket kredive dhe 9% të tregut të depozitave. Si rezultat, ne jemi bërë një nga aktorët kryesorë në sektorin financiar kombëtar. Ashtu si në vitet e kaluara, ne kemi ruajtur pozitën tonë udhëheqëse në biznesin e kredit-kartelave. Nëpërmjet Starkartelës (Starcard), kredit-kartela e parë me kështë në Kosovë, ne kemi ndryshuar mënyrën e shpenzimeve të konsumatorëve individualë në tregun e konsumit. Për më tepër, ne kemi lansuar disa nga produktet më të avancuara dhe unike në treg, duke përfshirë E-banking-un e sigurt, sisteme të përparuara dhe të shpejta të pagesave; kredi inovative dhe produkte të depozitave.

Ne ofrojmë gamën tonë të gjerë të shërbimeve financiare në tregun e Kosovës nëpërmjet 22 degëve dhe 379 punonjësve të përkushtuar, duke përfshirë edhe zyrën qendrore në Prishtinë. Përveç rrjetit tradicional të degëve, TEB Sh.A po ashtu i plotëson nevojat e klientëve nëpërmjet të gjitha linjave për: E-banking për individë dhe korporata, qendër të thirrjeve, 43 ATM-ve (Aparateve për tërheqje të parave) dhe më shumë se 2400 POS-ve (Pika të shitjes).

Ne jemi të angazhuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kemi prezantuar programet që synojnë reduktimin e dëmeve nga aktivitetet të cilat i financojmë.

TEB Sh.A përpiqet të tërheqë punëtorë më të mirë, që t'u shërbejnë klientëve dhe për të krijuar vlera afatgjate për aksionarët.

*Global 2000 Forbes 2011, renditur sipas vlerës së tregut.

VIZIONI

Të jemi banka më e mirë në Kosovë

MISIONI

Vazhdimisht të krijojmë dhe ngrisim vlerën e jashtëzakonshme për klientët tanë, aksionarët, të punësuarit dhe shoqërinë

STRATEGJIA

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë, strategjia jonë është që të ofrojmë një përvojë të shquar dhe efikase bankare për të gjithë klientët tanë. Ne e arrijmë këtë, duke ofruar produkte dhe shërbime të reja e praktike, për një rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.



Strategjia jonë përbëhet nga një numër i shtyllave kryesore:

Fokusi te konsumatorët

Kultura e biznesit e përqendruar te konsumatori, i mundëson TEB-it që të kuptojë dhe të parashikojë sjelljen e konsumatorëve, e cila, nga ana tjetër, rrit të ardhurat e bankës.

Fleksibiliteti

Në bazë të qasjes sonë të përqendruar tek klienti, ne ofrojmë shërbime të shumëllojshme bankare, në mënyrë që klientët të mund t'i përmbushin nevojat e tyre, si gjenden financiare dhe llogaritë, ashtu si u përshtatet atyre. Ky fleksibilitet do të thotë që klientët kursejnë kohë duke shijuar një gamë të plotë të shërbimeve bankare.

Gama e gjerë e linjave të shërbimeve të përshtatura për nevojat e klientëve

TEB Sh.A është e orientuar kah zgjidhja dhe ofron shumëllojshmëri të gjerë të shërbimeve financiare në tregun e Kosovës nëpërmjet një game të gjerë të linjave të shërbimeve. Ne kemi prani të fuqishme në tërë Kosovën: 22 degë, 43 ATM-a, 2400 POS-a, Qendrën e Thirrjeve, platforma mobile bankare dhe E-banking.

Rrjedhshmëria e qëndrueshme e të ardhurave

TEB Sh.A vazhdimisht po punon drejt përmirësimit të burimeve të saj të të ardhurave dhe profitit. Ne përqendrohemi në produktet me shkallë të lartë të kthimit dhe te segmentet fitimprurëse të biznesit.

Efikasiteti

Shfrytëzimi efikas dhe efektiv i burimeve janë objektivat kryesorë në TEB Sh.A. Strategjia jonë është që vazhdimisht ta ngrisin cilësinë e shërbimeve bankare dhe financiare, po ashtu nëpërmjet zhvillimeve më të fundit teknologjike, në mënyrë që të përqendrohemi në kontrollin e kostove bankare dhe ofrimin e shërbimeve dhe të produkteve në mënyrë më efikase.

Infrastruktura e përparuar teknologjike

Shërbimi bankar i TEB Sh.A ka dëshmuar se ka bërë një hap të madh përpara në Kosovë. Ne kemi sjellë arkitekturën e avancuar të sistemit bankar-teknologjik të biznesit dhe të tregut individual.

Menaxhimi i shëndoshë i rrezikut dhe auditimit

Përqendrimi i fortë i TEB Sh.A në menaxhimin e rrezikut dhe auditimit është një shtyllë e strategjisë së saj. Ne punojmë vazhdimisht që ta menaxhojmë dhe ta zbusim rrezikun, me vëmendje të veçantë tek ai i tregut, duke përfshirë rrezikun e normës së interesit, atë të likuditetit, rrezikun operacional, atë të kapitalit dhe rrezikun e çmimeve komode. Sistemi ynë i auditimit është proaktiv.

Stafi i përkushtuar

Suksesi dhe reputacioni i TEB Sh.A në sektorin bankar të Kosovës u arrit falë punës energjike dhe të palodhshme të punonjësve tanë.

Ambienti kreativ në punë

Profesionistët bankarë kërkojnë mjediset ku ata mund t'i përdorin dhe t'i ngrisin shkathtësitë dhe aftësitë e tyre për t'i shprehur vlerat dhe zgjuarsinë e tyre. TEB Sh.A ofron këtë mjedis për të punësuarit dhe vazhdimisht investon në një ambient pune ku punonjësit mund të zhvillohen dhe të shprehin vlerat e tyre.



VLERAT TONA THEMELORE

Azhuriteti

Shpejtësi në vlerësimin e situatave të reja dhe zhvillimeve, dhe në identifikimin e mundësive dhe riskut.

Efikasitet në vendim-marrje dhe në veprime.

Angazhimi

Zotimi për të shërbyer klientët dhe arritjen kolektive.

Sjellje shembullore.


Ambicia

Aspirat për sfida dhe lidership.

Dëshira për sukses ekipor në gara ku gjyqtar është klienti.

Kreativiteti

Përkrahja e iniciativave dhe ideve të reja.



Struktura e aksionarëve

Aksionarët	Deri më 31 dhjetor, 2011		
	Aksionet	Pronësia	Të paguara në kapital (€)
TEB Holding A.S.	2,150,000	100%	21,500,000
	2,150,000	100%	21,500,000

Të gjitha aksionet (100%) janë emetuar për TEB Holding A.S. me numër të regjistrimit të biznesit 176711 në Republikën e Turqisë.

Kapitali aksionar i Bankës është 21,500,000 euro, aksione të emetuara, secili me një vlerë nominale prej 10 eurosh.

Numri i aksioneve ka të bëjë me aksione të zakonshme pa të drejtë vote, preferenca apo kufizime të bashkëgjitura.

Kapitali aksionar është paguar me para në dorë.

Në përgjithësi, sistemi financiar në Kosovë mbeti me kapitalizim të mirëfilltë, likuid dhe fitimprurës duke qenë se shifrat e mjaftueshmërisë së kapitalit në vitin 2011 ishin

17.6%,

dhe raporti i kredisë ndaj depozitave ishte

81%.

Institucionet financiare si Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe Bashkimi Evropian (BE) me Bankën Qendrore Ekonomike (ECB) kanë zhvilluar programe financiare të destinuara për vendet periferike evropiane.

Gjatë vitit 2011, qeveritë dhe institucionet financiare në mbarë botën kanë punuar vazhdimisht për ta parandaluar recesionin e dyfishtë që dukej i pashmangshëm në verën e kaluar. Masat e marra përfshijnë aplikim të politikës monetare ekspansioniste dhe injektimin e kapitalit për t'i mbajtur bankat në funksion. Deri tani këto masa kanë qenë relativisht të suksesshme. Megjithatë, ekonomia globale nuk është e sigurt ende. Problemet strukturore janë themelet e krizës së tanishme dhe këto së bashku me sfidat e përhapura duhet të adresohen dhe trajtohen.

Institucionet financiare si Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe Bashkimi Evropian (BE) me Bankën Qendrore Ekonomike (ECB) kanë zhvilluar programe financiare të destinuara për vendet periferike evropiane. Nëpërmjet këtyre programeve dhe injektimeve kapitale shtesë nga ECB, u synua parandalimi i përhapjes së çrregullimit ekonomik në vendet më të vogla përreth eurozonës. BE-ja dhe ECB-ja miratuan masa dhe injeksione veçanërisht të rëndësishme në të holla nëpërmjet operacioneve afatgjata të refinancimit (LTRO-s), për vendet periferike që gradualisht çuan drejt ristrukturimit të borxhit të Greqisë. Të gjitha këto veprime kanë ndihmuar në stabilizimin e skenës evropiane, të paktën në një afat të shkurtër. Mbetet akoma

shumë për t'u bërë dhe shtetet e eurozonës po takohen rregullisht për të marrë hapa të mëtutjeshëm. Gjatë samitit të fundit, shumica e udhëheqësve të vendeve të BE-së u pajtuan për veprime të mëdha. Në samit u arrit marrëveshje rreth unitetit fiskal i cili do të ashpërsonte rregulloret rreth borxhit për vendet anëtare. Në të njëjtën kohë, Rezerva Federale e SHBA-së (FED) ka ruajtur politikën e saj të butë monetare, në bazë të parashikimeve të rritjes relativisht pozitive për Shtetet e Bashkuara në vitin 2012. Kjo ka kontribuar në më shumë siguri globale.

Kriza e tanishme, që filloi në mesin e vitit 2008, ndikoi rëndë në sektorin bankar. Një nga arsyt kryesore është se bankat janë një blerës i madh i obligacioneve qeveritare. Injektimi i likuiditetit në banka dhe detyrimi i tyre për të rritur bazën e kapitalit janë vetëm dy lëvizje nga autoritetet e BE-së që kanë për qëllim mbrojtjen e sektorit bankar kundër recesionit në të ardhmen. Kërkesat e reja të mjaftueshmërisë së kapitalit, të ngjashme me ato që tashmë janë në fuqi në SHBA, janë më të rrepta se kurrë më parë dhe bankat duhet t'i plotësojnë ato nga mesi i vitit 2012.

Kriza globale ka ndikuar negativisht edhe në rajonin e Ballkanit, ndërsa epiqendra ka qenë Greqia. Kosova, vendi i fundit i dalë nga lufta në ish-Jugosllavi, është

Injektimi i likuiditetit në banka dhe detyrimi i tyre për të rritur bazën e kapitalit janë vetëm dy lëvizje nga autoritetet e BE-së që kanë për qëllim mbrojtjen e sektorit bankar kundër recesionit në të ardhmen.

duke u përpjekur që të krijojë një bazë të shëndoshë ekonomike. FMN-ja tashmë ka zvogëluar parashikimin e saj për rritje ekonomike për vitin 2011 nga 5.3% në 5%. Pavarësisht rishikimit, rritja e GDP-së e tejkalon rritjen e parashikuar të vendeve fqinje. Komponentët kryesorë të rritjes janë kërkesa e brendshme e mbështetur nga rritja e konsumit privat dhe investimet e mbështetura nga investimet publike, kryesisht në infrastrukturën e autostradës.

Institucionet financiare u bënë më aktive në financimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ekonomike. Totali i ekspozimit të kredive u rrit për 16.4% nga viti në vit në 1.7 miliard euro në vitin 2011. Kreditë për ekonomitë familjare u rritën për 17.7% dhe arritën 0.5 miliard euro (26.4% nga viti në vit në 2010), ndërsa kreditë për ndërmarrjet u rritën për 13% dhe arritën në 1.2 miliard euro (7.3% nga viti në vit në 2010). Në përgjithësi, sistemi financiar mbeti me kapitalizim të mirëfilltë, likuid dhe fitimprurës duke qenë se shifrat e mjaftueshmërisë së kapitalit në vitin 2011 ishin 17.6%, raporti i kredisë ndaj depozitave 81%, ndërsa kreditë joperformuese u zvogëluan në 5.7% në vitin 2011 nga 5.9% në vitin 2010.

Rritja e konsumit privat dhe publik ndikoi në bilancin tregtar pasi importet u rritën me një ritëm të përsheptuar, ndërsa rritja e eksporteve mbeti e kufizuar. Eksportet kanë qenë 312.5 milionë euro në vitin 2011 dhe vazhduan të dominohen nga metalet bazë (61% e totalit të eksporteve). Nga ana tjetër, importet u rritën me 16% dhe arritën në 2.5 miliardë euro. Si pasojë, deficitin tregtar u zgjerua dhe arriti në 2.2 miliardë euro. Deficiti i llogarisë rrjedhëse u financua kryesisht nga remitancat (dërgesat nga jashtë) dhe investimet e huaja të drejtpërdrejta, të cilat FMN-ja i parasheh të jenë 550 milionë euro, përkatësisht 408 milionë euro. Në bazë të

kësaj përmirësimi i bilancit tregtar mbetet një sfidë për politikë-bërësit në të ardhmen.

Inflacioni i Kosovës është shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve në çmimet globale të ushqimit. Gjashtëmujori i parë i vitit 2011 është karakterizuar me rritje të konsiderueshme të çmimeve, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit, presionet inflacioniste pësuan zbutje. Në përputhje me trendin vjetor, inflacioni qëndronte në 3.6% në dhjetor 2011, pas një rritjeje dyfish të shifrave drejt mesit të vitit 2011, dhe viti përfundoi me një normë mesatare prej 7.3%. Si zgjidhje e situatës, dhënia përparësi agrikulturës si sektor ekonomik do të ndikonte në zvogëlimin e ndikimit të luhatjes së çmimeve në Kosovë të cilat vijnë nga jashtë.

Kriza e eurozonës pritet t'i reduktojë investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe remitancat, dhe mund ta pengojë rritjen e GDP-së nëpërmjet kërkesës së ulët të brendshme. Qeveria synon një deficit buxhetor primar prej 159 milionë eurosh deri në fund të vitit 2012 dhe planifikon për ta financuar deficitin me një sërë masash, të cilat përfshijnë emetimin e letrave me vlerë për herë të parë në historinë e Kosovës. Paraqitja e letrës me vlerë do ta zhvillojë sektorin financiar më tej dhe do të shumëfishojë mundësitë për investitorë. Buxheti përmban një klauzolë për mbajtjen e 60 milionë eurove të shpenzimeve të paalokuara, në mënyrë që të ruajë ekuilibrin e buxhetit në rast të vonësës në privatizimin e Telekomit pas 2012-s. Në anën e politikës monetare, legjislacioni i bankës qendrore u prezantua në vitin 2010, ndërsa legjislacioni për banka dhe mikrofinanca i cili është në proces e sipër, synon t'i reduktojë ekspozimin e bankave ndaj huamarrësve të vetëm nga 20% të kapitalit të ruajtur (Tier 1) në 15%. Masat fiskale dhe monetare kanë për qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë ekonomike.



Musa Erden

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Për të ardhmen, unë pres rezultate pozitive nga sinergjia ndërmjet një sistemi të qëndrueshëm financiar, zbatimit të reformave dhe gjithashtu shfaqjen e sektorëve strategjikë që do t'i formojnë në të ardhmen shtyllat e rritjes ekonomike për vendin.

Që nga viti 2008, ekonomia botërore është përballur me krizë financiare. Qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të zhvilluara kanë marrë masa aktive dhe kanë injektuar likuiditetet për të parandaluar ekonominë globale nga rënia në recesion. Gjatë vitit 2011, politikat monetare ekspansioniste dhe rikapitalizimi i bankave nëpërmjet injektimit të kapitalit nga ana e qeverive kanë parandaluar një rënie të dyfishtë.

Një numër i masave të aplikuara e kanë reduktuar mundësinë e dështimit bankar dhe shtetëror në Evropë, me përjashtim të Greqisë. Këto masa përfshijnë programet financiare të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Bashkimit Evropian (BE) për vendet periferike të Evropës, të shoqëruara nga operacionet e Bankës Qendrore Evropiane për marrëveshje për riblerje me kosto të ulëta dhe zotimin e Rezervave Federale të SHBA-së për të mbajtur norma të ulëta për trevjeçarin tjetër. Përveç kësaj, gjatë Samitit Evropian të fundit, qeveritë kanë ndërmarrë edhe hapa të rëndësishëm drejt zgjidhjes së krizës së eurozonës. Udhëheqësit e BE-së (25 nga 27 vendet e bllokut), ranë dakord për marrëveshje fiskale duke siguruar rregulla të përbashkëta për borxh për vendet anëtare. Si rezultat i kësaj, në fund të vitit u zvogëlua pasiguria financiare evropiane.

Sektori bankar ka qenë një nga sektorët që më së shumti është prekur negativisht nga kriza financiare globale, veçanërisht në vendet në zhvillim. Autoritetet evropiane, duke siguruar likuiditet për sistemin financiar, gjithashtu janë duke detyruar bankat që ta rrisin bazën e tyre të kapitalit. Autoriteti Bankar Evropian po kërkon nga bankat që t'i përmbushin rregullat e reja rreth kapitalit nga mesi i vitit 2012; autoritetet amerikane morën masa në një fazë të hershme të krizës globale për ta rikapitalizuar sistemin financiar.

Sa i përket Kosovës, ekonomia ka mbetur relativisht e paprekur nga kriza financiare në eurozonë, pjesërisht për shkak të integritetit të kufizuar të vendit në tregjet globale financiare. Rritja e importeve, të hyrat tatimore dhe kreditë për sektorin privat, të gjitha aludojnë në kërkesë të brendshme të fuqishme. Inflacioni është në rënie të shpejtë, pas një rritjeje dyshifrore të figurave drejt mesit të vitit 2011. Në sajë të një performance të shkëlqyer objektivat e planit fiskalë u tejkaluan, ku viti u përfundua me një deficit të

përgjithshëm prej 1.8% ose rreth 1%-pikë më e ulët se objektivi i buxhetit prej 2.9%. Përderisa shumë vende injektuan kapital dhe likuiditet shtesë në sistemin bankar, në mënyrë që t'i shpëtojnë ekonomitë e tyre nga recesioni, sektori financiar në Kosovë mbeti i kapitalizuar, likuid dhe fitimprurës. Gjatë kësaj kohe u prezantuan një mori rregullash dhe rregullore për ta forcuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Qëllimi ishte për t'i përmirësuar praktikën e menaxhimit të rrezikut dhe proceset vendim-marrëse të bankave. Asistenca për Likuiditet Emergjent (ELA) është gati të bëhet plotësisht operacionale dhe do të ofrojë masa mbrojtëse shtesë për sistemin.

Një tjetër hap para për sistemin financiar të vendit është emetimi i obligacioneve qeveritare për financimin e deficitit buxhetor që u bë për herë të parë në historinë e vendit. Në përputhje me strategjinë e zhvillimit të vendit, është përgatitur një pako e reformave, me qëllim të tërheqjes së më shumë investitorëve të huaj. Për të ardhmen, unë pres rezultate pozitive nga sinergjia ndërmjet një sistemi të qëndrueshëm financiar, zbatimit të reformave dhe gjithashtu shfaqjen e sektorëve strategjikë që do t'i formojnë në të ardhmen shtyllat e rritjes ekonomike për vendin.

Duke përdorur qasjen tonë inovative dhe të përqendruar te konsumatori në krijimin e marrëdhënieve të thella me klientët tanë dhe me qëllim të zgjerimit të bazës së klientëve nëpërmjet një portofoli të produkteve të gjëra, TEB Sh.A do të vazhdojë të krijojë vlerë të lartë të shtuar për aksionarët e saj dhe ekonominë në përgjithësi. Duke ndjekur me kujdes dhe duke analizuar trendet ekonomike në tregjet e huaja dhe vendëse, TEB Sh.A do të kërkojë krijimin e një baze të qëndrueshme të rritjes dhe fitimit, gjithashtu nëpërmjet menaxhimit të kujdesshëm. Ne nuk kemi asnjë dyshim se në ndërtimin e besimit dhe besnikërisë të konsumatorëve, ne do të jemi të shoqëruar nga ekspertiza e jashtëzakonshme dhe përkushtimi i punonjësve tanë. Përderisa ecim përpara, unë do të doja të shfrytëzoja një moment për të reflektuar për vitin që lamë pas dhe për të falënderuar konsumatorët tanë, të punësuarit, partnerët e biznesit dhe aksionarët.



Musa Erden

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

LETËR NGA KRYESUESI EKZEKUTIV
(CEO)

Alp Yılmaz
Kryesues Ekzekutiv (CEO)



Baza e klientëve tanë u rrit dhe tejkaloi numrin 135.000 deri në fund të vitit 2011 duke përfshirë komplet segmentet, e kjo tregon besimin e tregut drejt aktiviteteve tona, dhe shërben si dëshmi për cilësinë e shërbimeve tona.



Para se të vlerësoj aktivitetin e TEB-it në vitin 2011, unë do të doja të shpalosja pikëpamjet e mia lidhur me perspektivat dhe zhvillimet e ekonomisë së Kosovës.

Kriza e Eurozonës ka dominuar në lajmet e vitit 2011. Megjithatë, në Kosovë, ekonomia ka vazhduar trendin e rritjes, e mbështetur nga normat inkurajuese të rritjes dhe stabilitetin në politikën fiskale. Inflacioni ka rënë ndjeshëm në krahasim me rritjen dyshifrore në fillim të vitit 2011. Remitancat që kanë qenë prej kohësh një burim i përhershëm i fondeve hyrëse, kanë mbetur relativisht të qëndrueshme, pavarësisht krizës financiare nëpër shumë vende në Evropë. Konsumi i klientëve individualë dhe investimet në sektorin privat janë nxitësit kryesorë dhe kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin ekonomik.

Në tendencën e përgjithshme të rritjes, duke stimuluar sektorin privat dhe investimet, fuqia e kërkesës së brendshme ka kontribuar pozitivisht edhe në buxhetin e Qeverisë. Mbledhja e taksave është në rritje, duke ia mundur Qeverisë që të arrijë një baraspeshë fiskale. Për më tepër, rritja e të ardhurave tatimore në përputhje me zvogëlimin e kostove, i mundësuan Qeverisë që të mbajë ekuilibër fiskal. Si rezultat, në vitin 2011 ka pasur një rritje në shpërndarjen e fondeve nga buxheti për investime kapitale. Si pjesë e zhvillimit strategjik të Kosovës, investimet publike më shumë janë orientuar në modernizimin e infrastrukturës.

Sektori financiar i Kosovës është një nga burimet më të rëndësishme të financimit të konsumit privat. Sektori financiar i Kosovës me një kapitalizim të mirëfilltë është një përfaqësues i rëndësishëm dhe nxitësi kryesor i ekonomisë së vendit. Sistemi bankar qëndron në qendër të sektorit financiar, i cili po vazhdon të veprojë me qëndrueshmëri pasi që niveli i kredive joperformuese "NPL" është më i ulët në krahasim me sektorët bankarë të rajonit. Kjo tregon përshtatshmërinë dhe maturinë e politikave të rrezikut të zbatuara nga bankat komerciale në Kosovë, të cilat gjithashtu kontribuojnë në zhvillimet pozitive ekonomike. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) parashikoi një rritje të GDP-së prej 5,0% për vitin 2011, i cili është më i lartë në krahasim me rritjen e parashikuar prej 4% të vitit 2010.

Në përputhje me zhvillimin pozitiv të Kosovës dhe statistikat

e kënaqshme të zhvillimit, gjithashtu bilanci i sektorit bankar paraqet rritje pozitive. Totali i aseteve të këtij sektori shënoi rritje për 8.3% në vitin 2011 dhe arriti në 2.7 miliardë euro krahasuar me vitin 2010. Totali i kredive u rrit për 16.4% në 1.7 miliardë euro. Përveç kësaj, klientët gjatë gjithë vitit në këtë sektor përfituan për shkak të konkurrencës së forte dhe ndjeshmërisë së çmimeve.

TEB Sh.A si anëtar i ri në sektorin bankar, mori hapa të konsiderueshëm në aktivitetet e tij të biznesit dhe tani jemi një prej aktorëve më të fuqishëm në treg. Mbështetur nga forca ndërkombëtare financiare e rrjetit të grupit BNP Paribas dhe TEB A.Ş., TEB Sh.A është pjesë e një familjeje të forte globale. Klientët tanë në Kosovë përfitojnë nga kjo marrëdhënie si pasojë e transferimit të ekspertizës dhe qasjes në rrjetin global.

Viti 2011 ishte një moment historik për ne ku çdo linjë e biznesit ka gjeneruar rritje dhe performance të qëndrueshme. Nëpërmjet fleksibilitetit organizativ dhe reagshmërisë ndaj kërkesave të tregut, ne kemi qenë në gjendje të kapitalizojmë nga mundësitë e tregut, duke i rritur asetet tona të përgjithshme për 25.2% duke arritur një vlerë të përgjithshme prej 212.6 milionë eurosh. Strategjia jonë për mbështetjen e sektorit real dhe ekonomive familjare ndikoi në rritje për 52% në arritjen e vlerës prej 179.8 milionë euro. Ne tani kemi 11% të tregut në këtë segment.

Një prej qëllimeve tona është që të jemi banka më e mire dhe më e besueshme në Kosovë. Me qëllim të arritjes së këtij synimi, ne kemi arritur ta rrisim bazën e depozitave për 24% në arritjen e vlerës prej 182.8 milionë euro në vitin 2011, dhe arritëm një pjesë të tregut prej 9%.

Baza e klientëve tanë u rrit dhe tejkaloi numrin 135.000 deri në fund të vitit 2011 duke përfshirë komplet segmentet, e kjo tregon besimin e tregut drejt aktiviteteve tona, dhe shërben si dëshmi për cilësinë e shërbimeve tona. Duke gjykuar nga rezultatet dhe reagimet e klientëve të rinj dhe ekzistues, strategjitë e shitjes dhe marketingut janë dëshmuar të jenë të suksesshme. Për më tepër, nëpërmjet shërbimeve profesionale të personelit të përkushtuar dhe futjes së produkteve të përshtatshme për treg, TEB Sh.A arriti të krijojë një emër të fuqishëm i cili qëndron mbi shifrat e arritura dhe e dallon atë dukshëm nga konkurrenca.

Përderisa përqendrohemi në zhvillim të shëndoshë dhe të qëndrueshëm; përpjekja dhe energjia që ia kemi përkushtuar punës sonë rezultoi në arritjen e 2,4 milionë eurove shifra neto të fitimeve deri në fund të vitit. Si rezultat, norma e kthimit nga kapitali arriti 18.2% në krahasim me 2.1% në vitin 2010, ndërsa kthimi i asetëve arriti në 1.1% krahasuar me 0.2% në vitin 2010. Pavarësisht suksesit tone në zbatimin e strategjisë dhe vizionit, ne nuk kemi marrë vendime të paarsyeshme që do ta rrezikonin qëndrueshmërinë e ardhshme të bankës. Përveç bizneseve tona kryesore, departamentet e tjera si thesari, kartelat, financat tregtare dhe menaxhimi i parasë kanë sjellë rezultate të kënaqshme.

Përpjekjet tona u shpërblyen edhe ndërkombëtarisht. TEB Sh.A ka fituar “Çmimin e përsosmërisë” për pagesat nga Deutsche Bank. Çmimi i një prej bankave më prestigjioze në botë shpërbleu përkushtimin e TEB Sh.A drejt efikasitetit dhe shërbimeve më të mira bankare.

Përveç rritjes pozitive në bilancin e gjendjes të bankës, zhvillimet cilësore në produktet dhe shërbimet kanë përforcuar kënaqshmërinë e konsumatorëve. Duke i vendosur si prioritet përpjekjet për ta rritur cilësinë e operacioneve, ne arritëm sukses në raport me konsumatorët nëpërmjet një game më të gjerë të produkteve në vitin 2011. Ne vazhdojmë të krijojmë vlerë të shtuar duke i analizuar me kujdes nevojat e konsumatorëve, dhe nëpërmjet shfrytëzimit të përparësive teknologjike të cilat i posedojmë ofrojmë zgjidhje të përshtatshme, të cilat bëjnë ndryshimin dhe ngrisin kënaqshmërinë e konsumatorit.

Përderisa viti 2012 mund të konfirmohet si vit sfidues pasi që kriza financiare në Evropë po zgjidhet me një ritëm më të ngadalshëm, për Kosovën, investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe remitancat (dërgesave nga jashtë) mund të mbeten stabile. Në të njëjtën kohë, pritet një zvogëlim i deficitit të llogarisë rrjedhëse, kurse politikat fiskale mbeten në fuqi për ta ruajtur qëndrueshmërinë ekonomike.

Në vitin 2012, TEB Sh.A planifikon të vazhdojë me vrullin e rritjes në çdo linjë të biznesit dhe parashikon arritje tjera të veçanta, vazhdimisht duke u mbështetur në vlerat e saj themelore. Ne do të mbetemi vigjilentë dhe të përgjegjshëm për të gjitha zhvillimet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në ekonominë e Kosovës dhe nëpërmjet alokimit të duhur të fondeve do të stimulojmë sektorë që japin kontribut të qëndrueshëm në punësim dhe rritje ekonomike. Duke jetësuar strategjinë e saj, TEB Sh.A do të mbështetet në përpjekjet superiore të të punësuarve, besnikërinë e arritur të klientëve dhe mbështetjen e aksionarëve të saj.

Unë do të doja të përfitoja nga ky rast që të shpreh mirënjohjen tone për të gjithë të angazhuarit e veçanërisht për punonjësit të cilët nuk njohin kufij në ofrimin e shërbimeve, për aksionarët tanë që vazhdimisht na mbështesin, dhe mbi të gjitha për klientët që na frymëzojnë që të sjellim risi dhe të jemi të dalluar si TEB Sh.A.



Alp Yilmaz
Kryesues Ekzekutiv (CEO)

”

TEB Sh.A

NË PIKA TË SHKURTA

Rritje e fuqishme në biznes:

Profiti neto:

€ 2.4 milionë

Të hyrat bankare neto:

€ 16.6 milionë

Raporti kosto / Të hyra

67%

Kthimi në kapital:

18.2%





“Lëviz, dhe rrugët do të hapen.”

TEB-i NË VITIN 2011

TEB në shifra

Treguesit kryesorë financiarë

Shërbimi bankar për individë

Shërbimi bankar për NVM (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme)

Shërbimi bankar për biznese dhe korporata

Menaxhimi i parasë dhe pagesat

Biznesi i kartelave dhe qendra e thirrjeve

Financimi tregtar


Thesari

Burimet njerëzore


Teknologjia informative

INDIKATORËT E GJENDJES FINANCIARE


TEB-i NË SHIFRA




ASETET TOTALE



**KAPITALI I
AKSIONARËVE**



DEPOZITAT TOTALE




**KREDITË TOTALE
(BRUTO)**


* TË GJITHA SHUMAT JANË NË MIJËRA EURO

	2011	2010
TOTALI KREDIVE JOPERFORMUESE (NPL)/ KREDITE TOTALE	3.85%	1.45%
KREDITË / TOTALI I ASETVE	84.6%	69.70%
RAPORTI I MBULUESHMËRISË SË NPL	59.1%	75%


INDIKATORËT E PASQYRËS SË TË HYRAVE




**TË HYRAT BANKARE
NETO**



**TË ARDHURAT NETO
NGA INTERESI**



**TË ARDHURAT NETO
NGA JO-INTERESI**






**PROFIT VJETOR
NETO**



* TË GJITHA SHUMAT JANË NË MIJËRA EURO

	2011	2010
RAPORTI KOSTO / TË HYRA	67%	85%

Raportet e profitit



Aftësit paguese & Raportet e likuiditetit



* TË GJITHA SHUMAT JANË NË MIJËRA EURO

	2011	2010
DEGËT	22	21
TË PUNËSUARIT	379	342

Trendi i rritjes në asete vazhdoi dhe u shoqërua me rritje të vazhdueshme të profitit. Totali i aseteve arriti në 212.6 milionë euro, duke u rritur për 42.8 milionë euro ose 25.2%, ndërsa totali i portofolit kreditor është rritur në 179.8 milionë euro. Rritja neto e portofolios së kredisë ishte 61.5 milionë euro ose 52% krahasuar me vitin 2010.

Përderisa mëtojmë një shërbim më të mirë për konsumatorët tanë, ne jemi duke punuar pa u lodhur drejt zgjerimit të rrjetit dhe infrastrukturës së bankës sonë. Duke vepruar kështu, ne mbetemi të përkushtuar ndaj vlerave fundamentale tona dhe cazeve të performancës financiare.

Si rezultat të tërë kësaj në vitin 2011 kemi arritur rezultate të lakmueshme. Trendi i rritjes në asete vazhdoi dhe u shoqërua me rritje të vazhdueshme të profitit. Totali i aseteve arriti në 212.6 milionë euro, duke u rritur për 42.8 milionë euro ose 25.2%, ndërsa totali i portofolit kreditor është rritur në 179.8 milionë euro. Rritja neto e portofolios së kredisë ishte 61.5 milionë euro ose 52% krahasuar me vitin 2010.

Në anën e detyrimeve, depozitat e klientëve arritën në 182.8 milionë euro. Rritja neto e depozitave ishte 34.8 milionë euro ose 23.5% më shumë se në vitin e kaluar. Shuma prej 6.5 milionë eurove të borxhit të varur nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), kredi e kontraktuar gjatë vitit 2010 me një kohëzgjatje prej 10-vjetësh ka mbetur në të njëjtin nivel, ndërsa kapitali aksionar u rrit me 2.4 milionë euro ose 17.6% për shkak të shtimit të fitimit të vitit aktual në fitimet e pashpërndara.

Në fund të vitit 2011, përqindja e kredive joperformuese (mbi 60 ditë) ndaj totalit të kredive ishte 3.9%, në krahasim me 1.5% në fund të vitit 2010. Raporti tregoi një ndryshim prej 2.4% gjatë vitit 2011. Rritja e kredive joperformuese (NPL) është në rend të parë si pasojë e përkeqësimit të kushteve të likuiditetit në treg megjithëse treguesi i NPL të TEB Sh.A është në nivelin më të ulët në gjithë sektorin bankar. Në aspektin e shfrytëzimit të aseteve, struktura e totalit të aseteve tregon se 85% e tyre përbëhen nga kreditë dhe paradhëniet për klientët. Ky tregues në vitin 2010 ishte 70%.

Në të njëjtën kohë, rritja e përgjithshme e bilancit të gjendjes për vitin 2011 rezultoi në rritjen e përfitueshmërisë për bankën. Të hyrat neto nga interesi u rritën në 12.4 milionë euro nga 8 milionë euro sa ishin në vitin 2010. Rritja prej 4.5 milionë eurosh paraqet një rritje prej 55.9% krahasuar me vitin e kaluar. Të hyrat neto nga jo-interesi kanë qenë 3.9

milionë euro gjatë vitit 2011, duke u rritur për 1.4 milionë euro ose 53.7% krahasuar me vitin e kaluar. Raporti i kostove ndaj të hyrave në vitin 2011 u ul në 67% nga 85% sa ishte në vitin 2010, duke reflektuar në rritjen e kapacitetit gjenerues të të hyrave të Bankës nëpërmjet një strukture të kontrolluar të shpenzimeve operacionale. Të hyrat neto bankare u rriten në 16.6 milionë euro në krahasim me 10.8 milionë euro në vitin 2010 të nxitura nga një rritje e konsiderueshme në vëllimin e kredisë gjatë vitit. Rritja e theksuar në vëllim të kredisë dhe e përfitueshmërisë gjatë vitit 2011 rezultoi me fitim prej 2.4 milionë eurosh për vitin 2011, që është rreth tetë herë të fitimit prej 0.3 milionë gjatë vitit 2010.

Shkalla e kthimit të kapitalit (ROE) rezultoi të jetë 18.2% në krahasim me 2.1% në vitin 2010, ndërsa shkalla e kthimit të aseteve (ROA) u rrit në 1.1% në krahasim me 0.2% sa ishte në vitin e kaluar. Raporti i Neto interesit mbi asetet mesatare që fitojnë interes ishte 6.4%, duke shënuar një rritje nga 5.7% sa ishte në vitin 2010.

Sa i përket stabilitetit të Bankës dhe menaxhimit të likuiditetit, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) në fund të vitit 2011 ishte 13.1% që tregon një rënie prej 16.8% në vitin 2010, duke u nxitur kryesisht nga rritja e hovshme e portofolit të kredive gjatë vitit. Në përputhje me strategjinë e Bankës për optimizimin e pasurive (aseteve) drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë, përpjesëtimi i aseteve likuide ndaj aseteve totale ishte 15.7% në vitin 2011 duke u zvogëluar nga 28.7% sa ishte në vitin 2010.

Raporti i mbulimit të NPL në fund të vitit 2011 ishte 59.1% duke treguar një zvogëlim nga 75.0% sa ishte në vitin 2010. Ky ishte si rezultat i kredive të reja joperformuese me një shkallë më të ulët të provizionit. Asetet e bankës të peshuara me rrezik (RWA) arritën në 183.9 milionë euro nga 134.6 milionë euro sa ishin në vitin e kaluar, si pasojë e rritjes së portofolit të kredive.

Numri i degëve është rritur nga 21 në 22, ndërsa numri i të punësuarve është rritur nga 342, sa ishte në vitin 2010, në 379 deri në fund të vitit 2011.



Strategjia jonë është që t'u sigurojmë klientëve shumëllojshmëri të zgjidhjeve që i plotësojnë të gjitha kërkesat e tyre bankare dhe financiare. Ne dëshirojmë që shërbimet bankare t'ua bëjmë më të lehta dhe më të përshtatshme, duke ofruar zgjidhje - të gjitha shërbimet në një pikë.

100,000

Shërbimin individual aktualisht e kanë zgjedhur mbi 100,000 persona në rajone të ndryshme të Kosovës.

80%

Nëpërmjet zgjidhjeve inovative të kredisë ekspozimi i tyre është rritur për 80% në vitin 2011.

40%

Planifikimi i kursimeve bazike me menaxherin e llogarisë janë dëshmuar si shumë të popullarizuara dhe kanë shtuar kënaqshmërinë e konsumatorit. Qasja jonë është shpërblyer në treg me 40% rritje në vitin 2011.

Nëpërmjet qasjes sonë të përqendruar te konsumatori, shërbimi bankar për individë synon vazhdimisht të sigurojë mundësi unike për ta, nëpërmjet produkteve të reja që mbështeten në infrastrukturën e avancuar teknike dhe teknologjike.

Strategjia jonë është që t'u sigurojmë klientëve shumëllojshmëri të zgjidhjeve që i plotësojnë të gjitha kërkesat e tyre bankare dhe financiare. Ne dëshirojmë që shërbimet bankare t'ua bëjmë më të lehta dhe më të përshtatshme, duke ofruar zgjidhje - të gjitha shërbimet në një pikë. Aplikimi i kësaj strategjie, bën që të shndërrohem në bankën e vetme për klientë gjatë gjithë jetës së tyre.

Për shkak të standardeve të larta të shërbimit, ne jemi në gjendje të ofrojmë një përvojë unike bankare për shumë grupe të konsumatorëve individualë. Ne po ndërtojmë atë përvojë në bazë të ekspertizës së gjatë të kompanive tona bazë BNP Paribas dhe TEB Turqi. Pra, ne jemi një aktor shumë aktiv në tregun e Kosovës dhe tashmë kemi ndryshuar sjelljen bankare të klientëve individualë.

Konsumatorët individualë janë të mirëpritur nga Menaxher të portofolieve të përkushtuar që janë të specializuar në produktet përkatëse dhe në këshilla mbi përvojat më të mira. Kjo do të thotë se klientët tanë do të kenë shërbime cilësore

për t'i përmbushur nevojat e tyre të veçanta. Menaxheri i specializuar i Portofolit, fillimisht identifikon nevojat e klientit, duke marrë parasysh stadin në të cilin gjenden në ciklin e tyre të jetës. Menaxhimi i portofolit individual, në mënyrën si zbatohet nga TEB Sh.A, rrit kënaqshmërinë e konsumatorit duke i kombinuar produktet dhe shërbimet kryesore bankare me produkte të reja dhe praktike.

Risite e vazhdueshme në produktet individuale, qasja teknologjike në rritje e sipër dhe infrastruktura bankare e zgjeruar e bën vitin 2011 një vit i të arriturave të mëdha. Shërbimin individual aktualisht e kanë zgjedhur mbi 100,000 persona në rajone të ndryshme të Kosovës. Në vitin 2011, dosja e kredisë ishte rritur në 44 milionë euro, nëpërmjet gamës së gjerë dhe gjithnjë në rritje të produkteve të zhvilluara për tregun e Kosovës. Një produkt që pasqyron plotësisht qasjen tonë inovative është "Kredi me pauzë" që merr në konsideratë ngjarje të papritura dhe shpenzimet gjatë rrjedhës së kredisë. Kjo strukturë ua mundëson konsumatorëve të bëjnë një pauzë prej dy muajsh. Një tjetër tipar që ofron fleksibilitet për klientët e kredisë është "periudha e pauzimit" (Grace Period) që merr parasysh kohën e nevojshme për t'i përfunduar planet. Nëpërmjet zgjidhjeve inovative të kredisë ekspozimi i tyre është rritur për 80% në vitin 2011.

Duke krijuar një bazë të fortë të konsumatorëve në tregun e Kosovës nëpërmjet gamës sonë të produkteve të reja, të shërbimeve me cilësi të lartë, teknologjisë së përparuar dhe stafit të kualifikuar, ekipi ynë i shërbimeve individuale bankare është i sigurt se do të jetë në gjendje të vazhdojë me të njëjtën dinamikë të rritjes edhe në vitin 2012.

TEB Sh.A është i vetëdijshëm se, pavarësisht suksesit të arritur në vitet e fundit, sfidat dhe mundësitë janë përpara, e që do të kërkojnë angazhim absolut dhe azhuritë.

Në TEB Sh.A, ne e njohim rëndësinë e planifikimit të duhur gjatë jetës së klientit dhe jemi të përgatitur t'u ndihmojmë atyre në marrjen e produkteve më të mira. Planifikimi i kursimeve bazike me menaxherin e llogarisë janë dëshmuar si shumë të popullarizuara dhe kanë shtuar kënaqshmërinë e konsumatorit. Qasja jonë është shpërblyer në treg me 40% rritje në depozita në vitin 2011. Ne tani kemi një total prej 108 milionë eurosh në depozita. Suksesi është rezultat i besueshmërisë, cilësisë së shërbimit, kënaqshmërisë së konsumatorit dhe produkteve të reja, siç janë llogaritë e planifikuara dhe llogaritë fleksibile.

Starkartela është një kartelë e veçantë që u mundëson klientëve të blejnë me kështu me 0% interes dhe në të njëjtën kohë u ofron mundësi të fitojnë bonus pikë për çdo transaksion brenda rrjetit të TEB-it në Kosovë. STARKARTELA është e licencuar nga Visa kredit kartela. Në vitin 2011, numri i poseduesve të Starkartelës ka arritur në 79,000 klientë me ekspozim total prej 13.4 milion Euro.

Ne e kursejmë kohën e klientëve, duke u ofruar atyre zgjidhje të ndryshme bankare nëpërmjet mesazheve (SMS banking). Ky shërbim u mundëson klientëve të shikojnë gjendjen e tyre të llogarisë, të borxhit në Starkartelë, si dhe kursin valutor. Në të njëjtën kohë, konsumatorët mund të bëjnë pagesat për shërbime të internetit dhe shërbimet kablllore-televizive duke përdorur shërbimin SMS banking.

"TEB SMS Mbushje" është një tjetër risi e prezantuar nga banka jonë. Ajo i mundëson konsumatorit ta mbushë celularin nëpërmjet SMS-it në çdo rrjet

në Kosovë. Gjatë vitit 2011, 20.000 konsumatorë kanë shfrytëzuar shërbimin SMS banking. Ne kemi shërbimin E-banking më të avancuar në treg dhe vazhdimisht e zhvillojmë dhe përmirësojmë atë, duke inkuadruar tipare të reja. Që nga lansimi i tij në treg, ne kemi arritur të kemi 5.000 përdorues të shërbimit E-banking.

TEB Sh.A ofron shërbim të qendrës së thirrjeve 24/7 për klientët e saj individualë, në mënyrë që ata të mund të kryejnë shërbime bankare në çdo kohë dhe në çdo vend. Këtë shërbim gjatë vitit 2011 e kanë përdorur 36,000 klientë individualë.

Duke krijuar një bazë të fortë të konsumatorëve në tregun e Kosovës nëpërmjet gamës sonë të produkteve të reja, të shërbimeve me cilësi të lartë, teknologjisë së përparuar dhe stafit të kualifikuar, ekipi ynë i shërbimeve individuale bankare është i sigurt se do të jetë në gjendje të vazhdojë me të njëjtën dinamikë për vitin 2012. Ne do ta arrijmë këtë duke kërkuar shtimin e bazës së konsumatorëve, duke synuar këtu të gjithë klientët potencialë të shërbimeve bankare dhe Starkartelës. Ne kemi identifikuar tashmë grupe të ndryshme dhe do të përqendrohemi në fushata të veçanta për këto grupe. Në përputhje me zhvillimet e fundit, ne do të vazhdojmë të ofrojmë shërbime dhe zgjidhje që do të parashikojnë dhe të përputhen me nevojat e klientëve tanë dhe ndryshimin e stilit të tyre së jetesës.

TEB Sh.A është i vetëdijshëm se, pavarësisht suksesit të arritur në vitet e fundit, sfidat dhe mundësitë janë përpara, e që do të kërkojnë angazhim absolut dhe azhuritë.



TEB dhe klientët tanë individualë – duke e lehtësuar jetën – së bashku...



53%
rritje të portofolit të kredive

42%
të portofolit të depozitave

Ne ofrojmë një gamë të plotë të zgjidhjeve bankare për t'i fuqizuar konsumatorët e NVM-ve, duke lehtësuar ciklin e rrjedhës së parave.

Shërbimi bankar për biznese i TEB-it i ofron klientëve shërbime të shpejta nëpërmjet një qasjeje që e bën prioritet kënaqshmërinë e konsumatorëve dhe siguron që konsumatorët të ndjejnë se Banka gjithmonë po punon me ta.

Në shërbimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), TEB Sh.A synon të jetë banka e parë që të bie ndërmend. Objektivi ynë është që të jemi banka kryesore për këtë grup të konsumatorëve që janë ekonomikisht vendimtarë. Ne arrijmë këtë qëllim jo vetëm duke ofruar një gamë të plotë me cilësi të lartë të produkteve bankare dhe shërbimeve përkatëse, por edhe nga kërkimi dhe zhvillimi i zgjidhjeve për nevojat jofinanciare të NVM-ve.

Ne shërbejmë ndërmarrjet nga sektorë të ndryshëm me një qarkullim vjetor deri në 1.2 milion euro dhe aksionarët e tyre dhe pronarët duke përdorur qasjen tonë të përqendruar tek klienti. Parimi kryesor në sistemin bankar për NVM-të është që të zhvillohen marrëdhënie afatgjate dhe që të kontribuojnë më shumë për zhvillimin dhe rritjen e këtyre klientëve duke përdorur ekspertë të quajtur Menaxherë të Portofolios

Sistemi bankar TEB NVM ishte i pari në Kosovë që krijoi një qasje të përqendruar te klienti. Specialistët tanë "Menaxherët Portofolio" përqendrohen ekskluzivisht në një klient të veçantë dhe segment të sektorit, në mënyrë që ata të jenë të dy ekspertë dhe t'i kuptojnë më mirë nevojat e konsumatorit. Kjo do të thotë se ata mund të japin zgjidhje të përshtatshme për ta, të bazuara në treg. Menaxherët tanë të portofolios janë trajnuar dhe sjellin përvojë të gjerë të tregut të cilat janë në shërbim të konsumatorit.

Ne ofrojmë një gamë të plotë të zgjidhjeve bankare për t'i fuqizuar konsumatorët e NVM-ve, duke lehtësuar ciklin e rrjedhës së parave. Produktet e menaxhimit të parasë janë tregtuar intensivisht nëpërmjet zbatimit të Sistemit të Debitimit Direkt (DDS), sistemeve POS dhe të tjerave.

TEB Sh.A ka një infrastrukturë të avancuar të teknologjisë që na mundëson që të ofrojmë produkte bankare themelore, linja alternative të shpërndarjes dhe zgjidhjet e pagesave për klientët - në kohën dhe mënyrën e duhur.

Praktika e jonë më e mirë për vlerësimin e kërkesave për kredi duke përdorur analizën themelore dhe të përqendruar në klientë ka krijuar një portofol të shëndoshë dhe me cilësi të lartë të

aseteve. Gjatë vitit 2011, menaxherët tanë Portofolio kanë punuar intensivisht me klientët duke rezultuar në një rritje të portofolit të kredive për 53% dhe me 42% të portofolit të depozitave.

Duke iu ofruar klientëve të NVM-ve në financimin e kapitalit të punës dhe të investimeve, ne kemi mbështetur zgjerimin e biznesit të tyre duke e bërë atë më konkurrues.

Me pakot e produkteve dhe shërbimeve të ofruara në treg, në vitin 2011 kemi rritje të bazës së klientëve të NVM-ve për 54%. Produktet e përpunuara janë zhvilluar duke marrë në konsideratë strukturën e maturimit, specifikimet rajonale dhe sektoriale të kërkesave dhe nevojave.

Të gjitha të arriturat e vitit 2011 vijnë si rezultat i të punësuarve që adoptuan konceptin e menaxhimit të portofolios, mbështetjes së gjerë nga Zyra Qendrore në ofrimin e shërbimeve në kohën e duhur, punës ekipore dhe të përbashkët të departamenteve që rriten produktivitetin.

Agrikultura është një sektor me rëndësi strategjike në Kosovë. Ky sektor është aktualisht në procesin e ristrukturimit të shpejtë, konsolidimit dhe modernizimit. Kjo është arsyeja pse ajo është bërë një prioritet në rritje për TEB Sh.A. Duke punuar në bashkëpunim me USAID-in, ne kemi nisur një projekt që do të jetë një infuzion për këtë sektor me likuiditet thelbësor të nevojshëm për zhvillim.

Në vitin 2012, qëllimi kryesor bankar i NVM-ve është që t'i rrisë aksionet e tregut, në kredi dhe në depozita. Ne kemi për qëllim që të vazhdojmë me qasjen tonë të përqendruar tek klienti për çdo mbështetje të nevojshme për t'u ndihmuar klientëve ekzistues të NVM-ve në zhvillimin e tyre, duke arritur së bashku rritje fitimprurëse dhe të shëndetshme, dhe duke fituar konsumatorë të rinj. Ne do t'i arrijmë këto qëllime duke i kushtuar vëmendje të madhe forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve tona me konsumatorët, bashkëpunimin me organizatat vendore dhe hulumtime për t'i kuptuar më mirë nevojat e NVM-ve.

Qasja jonë e përqendruar tek klienti dhe e orientuar në zgjidhje bankare sjell produktet dhe shërbimet e përshtatshme për një treg në zhvillim të Kosovës. Ne vazhdojmë të investojmë në sektorë strategjikë që do të shpijnë drejt rritjes ekonomike dhe drejt vendeve të reja të punës.

Duke e kombinuar përvojën tonë vendore në treg me atë ndërkombëtare të BNP Paribas dhe TEB A.Ş., ne tashmë kemi arritur një reputacion për konceptin tonë të sofistikuar për klientët komercialë dhe për ata të korporatave. Qasja jonë e përqendruar tek klienti dhe e orientuar në zgjidhje bankare sjell produktet dhe shërbimet e përshtatshme për një treg në zhvillim të Kosovës. Ne vazhdojmë të investojmë në sektorë strategjikë që do të shpijnë drejt rritjes ekonomike dhe drejt vendeve të reja të punës.


Duke zhvilluar dhe zbatuar qasjen tonë të orientuar në zgjidhje, ne kemi krijuar një gamë të plotë të produkteve për klientët komercialë dhe ata të korporatave. Qëllimi ynë është që vazhdimisht të rrisim participimin në treg. Këtë e bëjmë duke ndërtuar marrëdhënie afatgjate të bazuara në cilësi të lartë të shërbimeve tona dhe sistemeve të avancuara të teknologjisë. Përveç produkteve bazike bankare, TEB Sh.A ofron edhe produkte të menaxhimit të parasë, kredi të importit për financimin e biznesit, kredi për kapital të punës, kredi për investime, letra të garancisë, letra të kredisë, financim për llogaritë e arkëtueshme dhe financim për furnizuesit. Të gjitha këto zgjidhje synojnë t'i forcojnë themelet e korporatave lokale që janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Të gjitha produktet dhe shërbimet tona për korporata, u ofrohen klientëve nga profesionistë të specializuar. Këta Menaxherë Portofolio zhvillojnë dhe ruajnë marrëdhëniet me klientët.

Çdo Menaxher Portofolio përpiqet që të sigurojë marrëdhënie afatgjate me klientët në bazë të zgjidhjeve të ofruara dhe shërbimeve të sofistikuara. Synimi ynë është që klientët tanë të jenë më konkurrues në treg dhe të fortë për të përfituar nga mundësitë për t'u zhvilluar.

Klientët komercialë dhe korporativë shërbehen në 17 degë në Kosovë, nga Menaxherë të përkushtuar të Portofolio. Përveç kësaj, në vitin 2010 ne kemi hapur një qendër speciale komerciale dhe korporative për të ofruar shërbim edhe më të mirë dhe për t'i përmirësuar edhe më tej marrëdhëniet tona me klientët. Nëpërmjet degëve tona, ne u ofrojmë klientëve tanë mundësi për perspektiva të reja të biznesit, jo vetëm në Kosovë por edhe në pjesë të tjera të botës nëpërmjet rrjetit global të BNP Paribas dhe të TEB A.Ş.

Pjesë e qëllimit tonë për t'u bërë banka më e mirë në Kosovë është që të jemi bankë e preferuar dhe e besueshme për klientët komercialë & korporativë. Kjo është arsyeja pse ne investojmë shumë në kënaqshmërinë e klientit. Kjo është arsyeja pse ne dëshirojmë ta fitojmë besnikërinë e konsumatorit me anë të qasjes sonë të përqendruar tek klienti dhe qasjes konkurruese, nëpërmjet zgjidhjeve funksionale dhe të shumëllojshme të menaxhimit të parasë, nëpërmjet infrastrukturës me teknologji të lartë dhe duke iu përgjigjur në kohë, kërkesave të konsumatorëve. Si Bankë, ne shohim besnikërinë e konsumatorëve të korporatave si test përfundimtar në parimin tonë për marrëdhënie afatgjate.



Në përputhje me këtë strategji, për shërbimet komerciale dhe korporative janë përcaktuar objektivat e mëposhtme në këtë segment:

- **Rritja e portofolit të kredisë dhe depozitave dhe**
- **Rritja e vëllimit të transaksioneve.**

Për t'i arritur këta objektiva, ne investojmë shumë në trajnimin e Menaxherëve Portofolio dhe po ashtu të gjithë stafit mbështetës në fokus të konsumatorëve me një theks të lartë në cilësinë e shërbimit. Në kredidhënie, kemi marrë parasysh studimet makroekonomike dhe ato të industrisë, si dhe vëllimin e çdo biznesi të kompanisë individuale, performancës financiare dhe marrëdhënieve ekzistuese me TEB Sh.A.

Duket se qasja jonë është duke u treguar e suksesshme për

konsumatorët. Në vitet e fundit, ne kemi financuar projektet dhe planet e biznesit për më shumë se 300 klientë të korporatave. Në vitin 2011, portofoli i kredive u rrit për 26% ndërsa ai i Financimit të Bizneseve për 53%.

Në planet e ardhshme në përputhje me zhvillimet në Evropë, ne parashikojmë që viti 2012 të jetë një vit i sfidave dhe vështirësive për ekonominë e Kosovës. Shërbimi bankar komercial dhe korporativ do të qëndrojë pranë klientëve të saj duke ndarë njohuritë lidhur me atë se si të zhvillohen në kohë të vështira dhe të paqëndrueshme. Edhe një herë, ne do të vazhdojmë të demonstrojmë besnikërinë dhe qëllimin për të qenë një mbështetës i madh i zhvillimit ekonomik. Klientët tanë do të vazhdojnë t'i marrin shërbimet më të mira të mundshme, të cilave do t'u shtohen produkte të reja dhe zgjidhje gjatë përpjekjes sonë për sukses të përbashkët. Në TEB Sh.A suksesi matet në bazë të suksesit që arrijnë klientët tanë.



Ne jemi të përkushtuar t'u ofrojmë klientëve tanë të biznesit një gamë të plotë të produkteve dhe shërbimeve për pagesa dhe menaxhim të parasë duke ofruar një varg të zgjidhjeve për të menaxhuar likuiditetin e kompanisë së tyre.

TEB Sh.A ka për qëllim vendosjen e standardeve të reja për të arritur përsosmëri në pagesa dhe zgjidhje të menaxhimit të parasë në Kosovë. Duke shfrytëzuar infrastrukturën e avancuar teknologjike, ne kemi nisur zgjidhje të reja për klientët tanë dhe kemi arritur të jemi ndër të parët në menaxhimin të parave dhe pagesave.

Nëpërmjet veprimeve të brendshme efikase dhe zgjerimit të rrjetit tonë bankar, ne ofrojmë shërbimet më të mira, më të shpejta dhe më të besueshme në tregun e pagesave. Për më tepër, të gjitha operacionet e pagesave, të transaksioneve, të thesarit dhe të letrave me vlerë janë trajtuar dhe proceduar me sukses. Ne kemi një rrjet të gjerë të bankave korrespondente me më shumë se 130 korrespondentë dhe mbi 30 banka për vendosjen e mjeteve.

Si një anëtare e rrjetit SWIFT dhe nëpërmjet infrastrukturës dypalëshe me 130 banka në mbarë botën, klientët tanë gëzojnë një avantazh të qartë, sidomos në transferimet ndërkombëtare dalëse. Në vitin 2011, ne kemi trajtuar më shumë se 20.000 transaksione, që shënon një rritje prej 17% në krahasim me vitin 2010.

Rritja e volumit të transfereve, po ashtu si rezultat i më shumë transaksioneve të drejtpërdrejta, tregon një nivel në rritje të vlerësimit të konsumatorëve për shërbimet tona. Megjithatë, ne gjithashtu kemi marrë mirënjohje nga Deutsche Bank AG në Frankfurt, Gjermani. TEB Sh.A ka marrë edhe "Çmimin e Ekselencës" për STP Transferet dalëse ndërkombëtare për vitin 2010 me suksesin e jashtëzakonshëm prej 99.96%.

Ne kemi adaptuar debitim direkt në sistemin tonë, një instrument pagese që administrohet nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Ky instrument pagese u mundëson konsumatorëve që të na autorizojnë për tërheqjen automatike të fondeve drejtpërdrejt nga llogaria e tyre bankare për të bërë pagesa të ndryshme mujore në kompani të ndryshme publike dhe private. Ky instrument përfaqëson një metodë të standardizuar dhe të automatizuar për pagesat mujore dhe është i përshtatshëm për të gjitha llojet e pagesave periodike dhe të rregullta me shuma fikse ose të ndryshueshme.

Ne jemi nismëtarë të një Sistemi të Pagesave të Faturave (IPS) në tregun e Kosovës. IPS është një sistem automatik i pagesave që ofron një gamë të gjerë të mundësive për pagesat e faturave periodike nga llogaritë bankare të klientëve tanë në konto të ofruesve (kompanive) të ndryshëm të shërbimeve. Ky shërbim është shumë fleksibil në përshtatjen e nevojave të klientit dhe mund të përdoret nëpërmjet linjave të ndryshme si: pagesa automatike e faturave (në mënyrë të përhershme), pagesat e faturave nëpërmjet transfereve, pagesat e faturave me të holla të gatshme dhe pagesa e faturave nëpërmjet E-banking-ut. Ne filluam zbatimin e këtij shërbimi në sektorin e sigurimeve dhe së shpejti do të kalojmë edhe nëpër sektorët e tjerë.

Nëpërmjet sistemit tonë inovativ dhe të orientuar kah zgjidhja i pagesave, kemi arritur rritje si në numër ashtu edhe në vëllimin e transaksioneve për shumëllojshmëri të pagesave të brendshme për individët dhe bizneset. Në vitin 2011, vëllimi i pagesave doganore u rrit me 56% dhe në vëllimin e pagesave të taksave me 40%. Në baza individuale, rritja më e lartë ishte në vëllimin e pagesave të pensioneve me 86%, ndërsa vëllimi i pagesave të shërbimeve publike u rrit për 82% në krahasim në vitin 2010.

Rritja e numrit të transaksioneve dhe vëllimeve çuan në rritje të dukshme të të hyrave nga komisionet

Duke ofruar produkte fleksibile dhe funksionale për menaxhimin e rrjedhës së parasë, TEB është e dedikuar t'u ndihmojë klientëve të biznesit duke u ofruar mundësi në zvogëlimin e shpenzimeve operative të biznesit, krijimin e përparësive në kosto dhe zvogëlimin e rrezikut nga grumbullimi i arkëtimeve të biznesit.

Ne jemi të përkushtuar t'u ofrojmë klientëve tanë të biznesit një gamë të plotë të produkteve dhe shërbimeve për pagesa dhe menaxhim të parasë duke ofruar një varg të zgjidhjeve për të menaxhuar likuiditetin e kompanisë së tyre. Zgjidhjet përfshijnë

pagesat, transferet, sisteme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme të bizneseve, llogaritë dhe kërkesat për informata.

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse ne po investojmë shumë në linja alternative dhe në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimit të E-banking për klientët e biznesit. Kjo siguron klientët me një platformë ultra-moderne të shërbimit pasi që ajo përdor sistemet më të avancuara të sigurisë dhe u jep qasje në shërbimet bankare 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Një zhvillim i rëndësishëm në E-banking për biznes gjatë vitit 2011 ka qenë mundësia e pagesave të internet nëpërmjet të cilës bizneset mund të paguajnë taksat e tyre nga zyrat e tyre në çdo kohë, 24/7. TEB është banka e parë e cila në bashkëpunim me administratën tatimore implementoi pagesat online të tatimeve.

Një nga kontributet kryesore të TEB Sh.A në Kosovë është Sistemi i Debitimit Direkt (DDS). DDS është një produkt unik në tregun e Kosovës që është projektuar për ta mbështetur bashkëpunimin komercial në mes bizneseve (B2B). Funksioni kryesor i këtij sistemi është që ta përmirësojë likuiditetin financiar të bizneseve duke ofruar menaxhim të plotë të grumbullimin e pagesave nga blerësit dhe pagesat e faturave komerciale ndaj kompanive furnizuese. Konsiderohet si sistemi më efektiv i menaxhimit të rrjedhës së parasë pasi që mbështetet nga teknologjia më e përparuar (cutting-edge) për ta mundësuar procesimin automatik të pagesave të plota. Si sistem, DDS ka një linjë kreditore të dedikuar për çdo kompani furnizuese i cili e lejon nga TEB Sh.A për ta lehtësuar klientin apo biznesin në mënyrë që të garantohet respektimi i plotë i afateve dhe kushteve të pagesave të faturave ndaj kompanive furnizuese. Në vitin 2011, numri i kontratave me kompanitë furnizuese është rritur në 33, ndërsa 4.500 blerës biznesi tanimë e kanë mundësinë e menaxhimit në blerjet e tyre nëpërmjet DDS-së. Grumbullimi i arkëtimeve përmes DDS-it është rritur për 397% në aspektin e vëllimit, dhe për 147% në aspektin e numrit të faturave. Numri i klientëve që përdorin DDS-në, si metodë komerciale për pagesat e faturave komerciale ndaj furnizuesit të tyre është rritur në 142%.

Në vitin 2012, TEB Sh.A do të përqendrohet në përmirësimin e mëtejshëm të kanaleve alternative, reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme në mes të konsumatorëve dhe prezantimin e një niveli më të lartë drejt automatizimit të pagesave. Do të ketë fokus të shtuar me zgjidhje të reja dhe të përshtatshme në menaxhimin e parave.

Strategjitë e ndryshme promovuese në kombinim me fokusin e konsumatorëve na mundësuan zhvillim në këtë segment.

Duke transferuar njohuritë e mëdha dhe përvojën e gjatë të BNP Paribas dhe TEB A.Ş. në tregjet e tyre përkatëse, TEB Sh.A ka qenë shumë i suksesshëm në krijimin e rrjetit të gjerë të pagesave. Duke e kombinuar njohurinë mbi praktikën me qasjen të përqendruar te klienti, ne kemi zhvilluar produkte në shërbim të sistemit të pagesave për të gjitha grupet e konsumatorëve në Kosovë. TEB A.Ş. ka qenë shumë aktiv në mbështetjen e themelimit të rrjetit tonë dhe të infrastrukturës. Ne kemi arritur të ndryshojmë shprehitë e pagesave dhe të bëjmë jetën më të lehtë për klientët tanë. Në fund të vitit 2011, ne kishim ndërtuar një portofol prej 93.000 debit kartelave, 79.000 kartela të kreditit, 43 ATM në mbarë Kosovën dhe më shumë se 2400 POS-a. Kjo e bën shërbimin bankar më të përshtatshëm, fleksibil dhe ofron më shumë mundësi për klientët tanë.

Aktualisht, TEB Sh.A ka licencë emetimi dhe pranimi prej një nga emrat më të njohur në biznesin e kartelave - VISA. Për shkak të ndryshimit të shprehive dhe avancimit të teknologjisë, debit kartelat gradualisht po fitojnë rëndësi të njëjtë me të hollat. Kjo është arsyeja pse ne kemi prezantuar me shpejtësi debit kartelat për klientët tanë. Kartelat e licencuara VISA të TEB Sh.A u mundësojnë klientëve të bëjnë tërheqje apo t'i përdorin ato për pagesa nëpërmjet internetit dhe të gjithë POS-ve nëpër botë. Kjo është vetëm njëra ndër gamat e plota të shërbimeve që ne ofrojmë për të dyja: individin dhe biznesin, përderisa vazhdojmë synimin për të qenë banka më e mirë në Kosovë.

Starkartela është produkt që i ka revolucionarizuar me të vërtetë shpenzimet e konsumit në Kosovë. Kjo kartelë krediti gjithashtu u ofron klientëve shumëllojshmëri të mundësive për financimin e blerjeve të tyre. Ajo ka qenë vendimtare në zhvillimin tonë dhe rritjen e shpejtë në tregun e Kosovës. Nëpërmjet Starkartelës, ne kemi qenë në gjendje të ndërtojmë një bazë solide të konsumatorëve dhe kemi depërtuar në treg. Baza jonë e konsumatorit gjithashtu paraqet një bazë të fortë për cross-selling (shitja e produkteve të reja për klientët ekzistues). Starkartela u prezantua në treg pas një analize të kujdesshme të nevojave të konsumatorëve për një kartelë krediti të këtij

lloji. Platforma e Starkartelës paraqet një përparësi të dyfishtë për të gjitha palët. Starkartela, kartela e parë në Kosovë, e bazuar në pagesë me këste, i jep shfrytëzuesit të saj edhe një bonus për çdo transaksion të kryer në kuadër të rrjetit të POS-ve të TEB-it në Kosovë. Bonusi i akumuluar mund të përdoret për blerje në rrjetin e tregtarëve të TEB-it. Gjithashtu, Starkartela posedon përparësi në blerje "online" pasi që blerjet janë të lira nga komisionet. Të gjitha tiparet e kësaj kartele janë vlerësuar mirë në treg pasi konsumatorët potencialë shpejt i janë përshtatur mundësive që ofron. Fushatat e rregullta dhe të shpeshta, për shtyrje të pagesave, të kësteve shtesë mbi blerjet dhe shpërblimet shtesë gjatë pushimeve, shërbyen si mjete për të nxitur më tej funksionimin e kësaj kartele. Strategjitë e ndryshme promovuese në kombinim me fokusin e konsumatorëve na mundësuan zhvillim në këtë segment. Tri vjet pas lansimit të Starkartelës, me më shumë se 79.000 kartela në treg ne jemi bërë lider në tregun e kredit kartelave.

Ne vazhdimisht po e rrisim cilësinë e shërbimeve dhe rrjetit tonë. Në fund të vitit 2011, TEB Sh.A ka pasur 43 ATM të instaluar në mbarë Kosovën. Nga to, 24 janë jashtë objekteve të bankës. Këta ATM u instaluan në vende të përshtatshme dhe strategjike pas analizës së kujdesshme se ku do të përfitojnë më së shumti klientët nga mbulimi me këtë shërbim. Në përputhje me strategjinë tonë për të ofruar produkte të sigurt, TEB Sh.A ishte banka e parë për lansimin dhe instalimin e pajisjeve "anti-skimming" të ATM-ve, pajisje që mbron kartelën e konsumatorëve nga kopjimi e të dhënave.


Në përpjekje për të siguruar shërbim dhe prani të plotë në treg, ne kemi zgjeruar më tej rrjetin tregtar në mënyrë që klientët tanë të kenë më shumë zgjidhje. POS-ët e TEB Sh.A janë bërë një kontribuues i rëndësishëm në të ardhurat e shitjes dhe ajo ka ndryshuar dinamikën konkurruese në treg. Për më tepër, duke qenë të parët në treg me GPRS POS, ne kemi vendosur standarde të reja dhe kemi përmirësuar performancën e shërbimit më të mirë dhe më të shpejtë për poseduesit e kartelave dhe bizneset. Numri i POS terminaleve të TEB-it të instaluar në fund të vitit 2011 arriti në 2,417, numri i tregtarëve

të regjistruar në sistem arriti 1.549, ndërsa qarkullimi nëpërmjet POS-ve është rritur 111% në krahasim me vitin 2010.

Ne kemi për qëllim që vazhdimisht ta rrisim kënaqshmërinë e konsumatorit dhe përdorimin e produkteve. Kjo është arsyeja pse ne kemi krijuar dhe zhvilluar një Qendër të Thirrjeve për klientët tanë që ofron shërbime 24/7 nga stafi i trajnuar profesional. Në përputhje me zgjerimin e Bankës dhe portofolin tonë të produkteve, janë rritur shërbimet nëpërmjet qendrës së thirrjeve. Klientët mund të marrin informata rreth borxhit dhe kredit kartelave, mbështetje rreth POS-ve, informata rreth kursit të valutave, informata për SMS banking, thjeshtë duke telefonuar në qendrën e thirrjes. Megjithatë, ka edhe më shumë. Ata po ashtu mund ta shikojnë statusin e aplikimit të tyre për një kartelë krediti dhe, pastaj, edhe mund të bëjnë pagesat për kredit kartela nëpërmjet qendrës së thirrjes. Duke e rritur avantazhin e konsumatorit për stimulimin e shitjes së mëtejshme, stafi i qendrës së thirrjeve është fokusuar veçanërisht në cilësinë e shërbimit. Kjo është arsyeja pse ne i monitorojmë thirrjet e konsumatorëve për qëllime të trajnimeve dhe për ngritje të cilësisë së shërbimeve. Përderisa rritet baza e klientëve tanë, gjatë vitit 2011 po ashtu u rrit edhe numri i thirrjeve në këtë qendër.

Momenti më pozitiv u arrit në vitin 2011 e që me siguri do të vazhdojë gjatë vitit 2012, pasi që jemi vazhdimisht duke punuar në produkte dhe shërbime të reja për ta bërë bankën edhe më konkurruese. TEB Sh.A do të jetë banka e parë në Kosovë që futi kredit kartelën me bonus për bizneset. Qëllimi është që klientët tanë të korporatave dhe komerciale t'i integrojmë në biznesin e Starkartelës për blerjet e tyre të përditshme. Për më tepër, përfitimet nga besnikëria e konsumatorit do të përforcojnë projektet për lansimin e kreditkartelave të reja që do t'i shpërblejnë përdoruesit më të shpeshtë, që janë në fazën përfundimtare të zhvillimit. Ne gjithashtu do të zhvillojmë fushata më të shpeshta dhe do të ofrojmë më shumë mundësi për të mbledhur bonuse, duke e integruar edhe më shumë teknologjinë e avancuar sa i përket marrëdhënies së menaxhimit të konsumatorëve. Menaxhimi i fushatave do të bashkërendohet për të arritur efikasitet më të madh. Në ofrimin e produkteve të sigurt, do të përmirësohet siguria në debit kartela, ku do të përmirësohet fusha magnetike e cila do të zëvendësohet me 'Chip EMV - DDA (për vërtetimin e të dhënave).

Ne jemi të bindur se mund ta përballojmë dinamikën e rritjes nëpërmjet cilësisë së shërbimeve tona dhe për ta arritur qëllimin tonë për t'u bërë banka e parë e zgjedhur për të arritur numër edhe më të madh të konsumatorëve.





Në vitin 2012, ne do të përqendrohemi në strukturimin efektiv dhe produktiv të transaksioneve të tregtisë së jashtme. Ne parashikojmë se roli i bashkëpunimeve ndërkombëtare do të rritet pasi kushtet e tregut do të kërkojnë sigurinë e shtuar për marrëveshjet e biznesit.

Profesionalizmi dhe ekspertiza do të jetë udhëzuesi ynë pasi ne i konsiderojmë këto si të rëndësishme në një botë në lëvizje të shpejtë.

Në financat tregtare, ne ofrojmë zgjidhje financiare të përshtatura për kërkesat e konsumatorëve dhe në përputhje me zhvillimin e tregut. TEB Sh.A sjell traditën e gjatë dhe ekspertizën e gjerë të BNP Paribas dhe TEB A.Ş. për klientët tanë, duke mundësuar që ata të zhvillojnë biznesin duke përdorur praktikën më të mira ndërkombëtare. Ne ofrojmë një gamë të gjerë të produkteve për financimin e biznesit për operacionet në dokumentacion, duke përfshirë letër kreditë për import dhe letër kreditë për eksport, letër-garancionet bankare kombëtare dhe ndërkombëtare, letër kreditë 'stand-by', dhe inkasot dokumentare. Për më tepër, ekspertiza jonë e gjerë do të thotë që ne mund t'i përshtatim produktet në mënyrë specifike për nevojat e tregut.


Ne operojmë në një treg konkurrues. Strategjia jonë është t'u ofrojmë klientëve tanë ekspertizë dhe njohuri të vërtetë. Ekspertët dhe Portofolio Menaxherët janë trajnuar të sigurojnë klientët tanë me produkte të reja fleksibile dhe shërbimet që minimizojnë rrezikun dhe shpenzimet. Nëpërmjet kësaj qasjeje, ne kemi arritur tashmë një reputacion të fortë në besueshmërinë e klientëve tanë. Kjo është e qartë nga rritja e qëndrueshme e bazës së klientëve tanë.

TEB Sh.A kupton faktin se biznesi ndërkombëtar në një botë të globalizuar është një sfidë dhe suksesi kërkon njohuri të gjerë profesionale dhe një rrjet efektiv. Duke e zgjeruar rrjetin tonë vazhdimisht, duke forcuar marrëdhëniet me bankat e tjera, duke rritur standardet tona tashmë të larta të profesionalizmit dhe kompetencës, ne synojmë t'i mbështesim klientët tanë duke iu përshtatur nevojave të tyre për zgjidhje financiare dhe bankare.

Duke përdorur ekspertizën e BNP Paribas dhe TEB A.Ş. në tregun ndërkombëtar, ne jemi duke e zgjeruar vazhdimisht mbulueshmërinë gjeografike dhe ndryshueshmërinë e produkteve. Në vitin 2011, ne edhe më tej e kemi zgjeruar rrjetin bankar me 130 korrespondentë në mbarë botën. Për më tepër, në mënyrë që t'i plotësojmë nevojat e financimit të importit dhe eksportit, në vitin 2011 u anëtarësua në programin për lehtësim të tregtisë "World Bank International Finance Corporation's (IFC)". Duke nënshkruar marrëveshjen me IFC, ne jemi bërë edhe më fleksibil për t'iu përgjigjur kërkesave në lidhje me garancitë dhe letër-kreditë e konfirmuara dhe duke zgjeruar më tej marrëdhëniet tona me bankat e reja të huaja.

Në vitin 2011, transaksionet financiare u rritën për 57% në krahasim me vitin 2010. Ka pasur një rritje prej 31% në garancitë bankare ndërkombëtare.

Në vitin 2012, ne do të përqendrohemi në strukturimin efektiv dhe produktiv të transaksioneve të tregtisë së jashtme. Ne parashikojmë se roli i bashkëpunimeve ndërkombëtare do të rritet pasi kushtet e tregut do të kërkojnë sigurinë e shtuar për marrëveshjet e biznesit. TEB Sh.A ka për qëllim ta rrisë numrin e bankave korrespondente. Ne do të vazhdojmë t'i mbështeteshim klientët tanë, duke siguruar një urë të sigurt për mundësi të reja. Profesionalizmi dhe ekspertiza do të jetë udhëzuesi ynë pasi ne i konsiderojmë këto si të rëndësishme në një botë në lëvizje të shpejtë.



Qëllimi ynë kryesor në thesar është ta maksimizojmë kthimin në afat të gjatë duke menaxhuar rrezikun. Në kuadër të thesarit, ne krijojmë strategji të investimeve dhe fondeve bazuar në kushtet mbizotëruese të tregut, strategji për normat e interesit, strategji për tendencat e rritjes së bilancit të gjendjes si dhe strategji për parametrat e rrezikut.

Një Thesar i fuqishëm dhe gjithëpërfshirës si dhe menaxhimi i aseteve dhe detyrimeve janë çelësi kryesor për të gjitha bankat. Është e një rëndësie të veçantë që të sigurohen shërbime të qëndrueshme dhe të sigurta financiare për klientët. Qëllimi ynë kryesor në thesar është ta maksimizojmë kthimin në afat të gjatë duke menaxhuar rrezikun. Në kuadër të thesarit, ne krijojmë strategji të investimeve dhe fondeve bazuar në kushtet mbizotëruese të tregut, strategji për normat e interesit, strategji për tendencat e rritjes së bilancit të gjendjes si dhe strategji për parametrat e rrezikut. Thesari është gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit të Bankës dhe çmimin e saj referues në tregje, rrezikun operacional dhe strukturor, rrezikun e këmbimit valutor dhe rrezikun që vjen si pasojë e lëvizjeve të normave të interesit në pozicione të bilancit të gjendjes.

Ne i menaxhojmë asetet dhe detyrimet në mënyrë të vazhdueshme duke analizuar rreziqet e mundshme si dhe mundësitë që i ofron tregu në kuadër të rregullave (kornizave) të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve dhe Komisionit për menaxhimin e Mjeteve dhe Detyrimeve (ALCo). Për menaxhimin e përditshëm të likuiditetit dhe rreziqet që lidhen me strukturën e aseteve dhe detyrimeve tona, bordi e ka deleguar përgjegjësinë tek anëtarët ALCo-s. ALCo mblidhet çdo dy javë për të diskutuar zhvillimet e fundit të tregut dhe për të marrë vendime në përputhje me parimet e vendosura për reduktimit/zvogëlimin e rrezikut. Ky trup monitoron dhe udhëzon të gjitha aktivitetet dhe veprimet operationale të thesarit në një bazë të vazhdueshme duke operuar brenda standardeve dhe politikave të përcaktuara.

Ne vazhdimisht monitorojmë dhe menaxhojmë likuiditetin, valutat e huaja dhe rreziqet nga normat e interesit që mund të lindin nga operacionet tona rutinore. TEB Sh.A punon ngushtë me TEB A.Ş., duke përfutur nga parashikimet e sakta të tregut, veçanërisht për hendeqet/GAP-at në normat e interesit dhe menaxhimin e likuiditetit.

Kontrolli i rreptë i brendshëm është çelësi për të gjitha aktivitetet tona të thesarit. Ne kemi zhvilluar dhe zbatojmë praktikrat më të kujdesshme që zvogëlojnë dhe zbusin rrezikun në aktivitetet tona të menaxhimit të aseteve.

Aktivitetet e menaxhimit të aseteve kryhen në përputhje me strategjinë e Bankës dhe të biznesit të përgjithshëm e që për qëllim primar kanë maksimizimin dhe menaxhimin e rrezikut në kthimin e kapitalit të TEB Sh.A.

Disa nga klientët tanë të korporatave gjithashtu vijnë te ne direkt për çmimet e produkteve të thesarit, ndërsa të tjerët shërbejnë nëpërmjet rrjetit të degëve tona. Kjo do të thotë që klientët tanë mund të përfitojnë edhe nga përvoja e plotë ndërkombëtare që banka sjell në operacionet e veta të thesarit.



“ Nëse të gjithë
lëvizin përpara së
bashku, atëherë
suksesi vjen vet.”

Henry Ford

Ne jemi shumë të vetëdijshëm që kënaqshmëria e klientëve është fuqimisht e lidhur me kënaqshmërinë e nëpunësit. Kjo është arsyeja pse nëpunësit e përkushtuar dhe besnik shihen si pasuritë tona më të rëndësishme.

Në mjedisin e sotëm tejet konkurrues të shërbimit, ku pritjet e klientëve janë duke u rritur dhe teknologjia po zhvillohet me një ritëm të shpejtë, të pasurit burime njerëzore shumë të kualifikuara dhe të motivuara është thelbësore për zbatimin e strategjive dhe qëllimeve të korporatës. Në njohjen e këtij mjedisi konkurrues dhe në përputhje me vizionin dhe strategjinë e TEB Sh.A-së, ne synojmë të tërheqim individë shumë të kualifikuar dhe me potencial të lartë për t'u shërbyer klientëve tanë. Ne ofrojmë mbështetjen thelbësore dhe trajnimin e profesionistëve tanë, në mënyrë që ata të na ndihmojnë të vendosim standarde të shërbimit në sektor. Ne punojmë shumë në mbajtje (të stafit). TEB Sh.A ofron mundësi të karrierës, vlerësim të bazuar në performancë (kryerje të punës) dhe një mjedis që është fleksibil dhe i inkurajon njerëzit tanë për të zhvilluar krejtësisht grupe të shkathtësive të veçanta dhe të arrijnë potencialin e tyre.

Integrimi i politikave të Burimeve Njerëzore në kulturën dhe strategjinë e korporatës na mundëson të krijojmë një avantazh konkurrues në sektorin financiar. Duke rekrutuar dhe mbështetur nëpunësit të cilët janë mirë të shkolluar, të hapur ndaj inovacionit dhe ndryshimeve, që posedojnë potencial për vetëzhvillim, që janë aktor ekiporë që mund të adoptojnë vlerat e korporatës dhe u zotohen atyre, ne ia kemi dalë ta forcojmë pozitën tonë të tregut dhe atë të rrisim rrugën tonë të shtimit fitimprurës, duke i ofruar tregut produkte cilësore dhe inovative.

Në njohjen e këtij mjedisi konkurrues dhe në përputhje me vizionin dhe strategjinë e TEB Sh.A-së, ne synojmë të tërheqim individë shumë të kualifikuar dhe me potencial të lartë për t'u shërbyer klientëve tanë.

Ekipi ynë i burimeve njerëzore i kushton përpjekje dhe kohë të rëndësishme krijimit të një kulture shpërblyese të korporatës që inkurajon performancë (kryerje pune) superiore në mesin e nëpunësve dhe u jep atyre një ndjenjë të arritjes personale në punën e tyre. Duke përhapur në mënyrë efektive rezultatet e punonjësve, ne sigurohemi që nisma dhe kontributi i punonjësve të vlerësohet nga menaxhmenti i tyre.

Duke qarkulluar arritjet dhe duke kontribuar në një kulturë bashkëpunimi të korporatës, ne i inkurajojmë punonjësit të jenë proaktiv dhe ta përmbushin potencialin e tyre. Ne jemi të vetëdijshëm se kënaqshmëria e klientit është e lidhur fuqimisht me kënaqshmërinë e nëpunësit. Kjo është arsyeja pse nëpunësit e përkushtuar dhe besnik shihen si pasuritë tona më të rëndësishme. Të gjitha strategjitë dhe qëllimet janë hartuar bashkë me ta në kryeqendër. Për ta shtuar dhe shpërblyer besnikërinë në mesin e nëpunësve, ne e kemi vënë në funksion strukturën e shpërblimit që bazohet në menaxhimin e performancës së drejtë. Ky është një sistem që siguron arsimim të mëtutjeshëm profesional përmes një shumëllojshmërie të trajnimeve dhe ka për prioritet ngritjen në pozita për brenda përmes mundësive për t'u avancuar në karrierë. Për të krijuar një lidhje të fortë dhe duke kontribuar për të dyja, kënaqësinë e tyre personale dhe profesionale, ne vazhdimisht organizojmë ngjarje dhe aktivitete sociale, të tilla si ahengje, dreka dhe darka mirënjohëse, turne futbolli dhe basketbolli, boulling, paintball, udhëtime dhe piknikë.

Trajnimi i nëpunësve dhe investimet e duhura në njerëzit tanë janë të bashkërenduara ngushtë me objektivat e korporatës dhe janë plotësuese ndaj praktikave tjera të burimeve njerëzore. Programet e trajnimit janë të dizajnuara për të përgatitur personelin për punët dhe detyrat e tyre të caktuara, si dhe për t'i pajisur ata me njohuritë dhe

kompetencat e nevojshme. Ne kontribuojmë në forcimin e aftësive të punonjësve në mënyrë që ata janë të përditësuar vazhdimisht mbi ndryshimet e brendshme, produktet dhe shërbimet e reja, dhe ndryshimet në treg dhe në legjislacion dhe në rregullore.

Burimet Njerëzore veprojnë ngushtë dhe në mënyrë të vazhdueshme me krerët e departamenteve të tjera për të zhvilluar, planifikuar dhe organizuar programet e nevojshme të trajnimit, brenda dhe jashtë. Ne angazhojmë stafin e brendshëm si "Trajnues Vullnetar" në mënyrë që përvoja e tyre dhe gama e ekspertizës të mbahet për Bankën dhe të ndahet me bashkëpunëtorët.

Duke përdorur përpjekjet, njohuritë, aftësitë dhe energjinë e tyre, të punësuarit tanë kanë qenë tejet të dobishëm në zgjerimin e reputacionit të bankës si korporatë e po ashtu edhe pjesëmarrjen që ka në treg. Në katër vitet e para të operacioneve, TEB Sh.A ka arritur një model me rritje të shëndoshë të pjesëmarrjes në treg. Ne besojmë se kjo është për shkak të 379 (2010: 342) nëpunësve tanë të përkushtuar dhe shumë të kualifikuar. Duke paraqitur veten e tyre në treg si profesionistë të besueshëm dhe të shkathët që posedojnë aftësi komunikimi të përshtatshme për grupe dhe segmente të ndryshme të klientëve, nëpunësit tanë ia kanë shtuar vlerën brendit të korporatës dhe më tutje e kanë ngritur profesionin bankar si një profesion të respektuar. Nëpërmjet reputacionit të fortë personal të nëpunësve tanë, Banka ka qenë në gjendje të krijoj marrëdhënie shumë të shëndetshme dhe produktive me klientët dhe tregun derisa e përkthejmë strategjinë tonë në veprim në Kosovë.

Në vitin 2012, Burimet Njerëzore të TEB Sh.A do të vazhdojnë të punojnë në përputhje me ligjet e punës duke bërë investime efikase dhe të përshtatshme në përmirësimin e strukturës për shpërbllim.

NUMRI I NËPUNËSVE

2010  342

2011  379

TEB Sh.A përpiqet që të jetë një lider në paraqitjen e shërbimeve të sigurta automatike që do ta rrisin praninë tonë në treg duke përdorur teknologjinë e tanishme dhe të përditësuar.

Teknologjia informative (IT) është një nga mjetet më të rëndësishme në sektorin bankar, jo vetëm për zhvillimin e shërbimeve dhe të produkteve të reja për konsumatorët, por edhe për mbajtjen konfidenciale të të dhënave të klientëve në një mjedis të sigurt. Ne punojmë në pajtim me proceset ITIL dhe sipas standardeve Cobit dhe CMMI.

Profesionistët tanë IT kuptojnë plotësisht se sa të rëndësishme janë këto mjete, sidomos për pozitën tonë konkurruese. Kjo është arsyeja pse aktivitetet e departamentit të IT-së i janë përshtatur vizionit dhe strategjisë së Bankës, duke siguruar sisteme të sigurta dhe të besueshme të informacionit.

TEB Sh.A përpiqet që të jetë një lider në paraqitjen e shërbimeve të sigurta automatike që do ta rrisin praninë tonë në treg duke përdorur teknologjinë e tanishme dhe të përditësuar. Ne jemi në dijeni që teknologjia është duke u bërë me ndikim të madh në ofrimin e shërbimeve bankare dhe ky ndikim sa vjen e rritet, ka një korrelacion të fortë me kënaqshmërinë e konsumatorëve. Në vitet e fundit, sjelljet bankare të konsumatorëve kanë ndryshuar, pasi që shumë shërbime kanë lëvizur nga pika tradicionale e ofrimit të shërbimeve (degë) në linjat alternative të tilla si E-banking, SMS-të bankare dhe ATM-të. Duke qenë lider në paraqitjen e këtyre linjave të reja, dhe duke ofruar sisteme të sigurta në 24/7, kemi për qëllim të pasurojmë përvojën bankare për klientët tanë.

Duke iu përshtatur ndryshimeve në teknologji, ekipi ynë i IT-së angazhohet pandërprerë duke ofruar mbështetje të vazhdueshme në sigurimin efektiv të shërbimeve të përditshme. Përveç kësaj, me përafrimin e aktiviteteve me pozicionin strategjik të Bankës, struktura jonë organizative e IT-së është projektuar për të parashikuar dhe për t'u përshtatur më lehtë për ndryshime, duke siguruar një reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve të ardhshme.

Sa i përket IT-së, TEB Sh.A është e përqendruar në:

- Investimin në punonjësit tanë të IT-së;
- Sigurimin e investimeve financiare në IT, për ta përmirësuar efikasitetin dhe efikasitetin e programeve që përdoren në Bankë;
- Sigurinë dhe mbrojtjen e informatave;
- Identifikimin e fushave ku zgjidhjet optimale mund të realizohen në bankë;
- Kryerjen në kohë të projekteve të IT-së brenda buxhetit të planifikuar duke dhënë rezultate të pritshme.

Në përputhje me qasjen tonë të orientuar në klientë, në zhvillimin e zgjidhjeve sipas nevojave të klientit dhe kërkesave për biznesin tonë, TEB Sh.A ka arritur disa momente historike në drejtim të inovacionit dhe kontributit në sektorin bankar në Kosovë. IT-të tanë janë përqendruar shumë në zhvillimin e produkteve të reja dhe shërbimeve që do të na mundësojnë të mbesim afër klientëve tanë. Sistemi Starcard dhe SMS-banking ishin disa nga risitë kryesore që ne kemi nisur në Kosovë. Në përputhje me qëllimet tona të biznesit, ne jemi të parët që ofrojmë Starkartelë, një kartelë krediti me kështu dhe mundësinë e fitimit të pikëve gjatë transaksioneve në pikat e shitjeve.

Në përputhje me nevojat e klientëve të cilët duan shërbime bankare kudo dhe në çdo kohë, ne kemi investuar në përmirësimin e infrastrukturës së E-banking dhe SMS-banking duke vendosur standarde të reja të shërbimit. Ne ishim banka e parë në Kosovë për të ofruar shërbime bankare me SMS. Ndërsa SMS Mbushje (Mobile) është zhvilluar në vitin 2010. Në ndërkohë, ky shërbim është zgjeruar dhe tani u lejon konsumatorëve qasje për t'i paguar shërbimet kabllore dhe internetin. E-banking, PIN (OTP) ishte gjithashtu i pari në tregun e Kosovës me sigurinë shtesë, i prezantuar për konsumatorët komercialë. Për t'i plotësuar nevojat e konsumatorëve për lehtësi dhe efikasitet në pagimin e tatimeve të tyre, kemi inkuadruar edhe pagesa online të tatimeve. Për më tepër, Sistemi i Debitimit Direkt (DDS) ka qenë i integruar dhe është zbatuar me anë të E-banking-ut.

Gjatë vitit 2011, janë implementuar 59 projekte që rrisin efikasitetin e sistemit informativ të menaxhimit dhe infrastrukturës për menaxhimin e rrezikut, derisa sistemi i sigurisë është përmirësuar dhe është plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore.

Ne jemi të vetëdijshëm se teknologjia informative përfaqëson thelbin e inovacionit dhe diferencimit. Kjo është arsyeja pse TEB Sh.A do të vazhdojë të investojë në IT. Pasi që shërbimet po bëhen më të automatizuara, ne do t'i shfrytëzojmë ato në mënyrë që të kuptojmë më mirë nevojat e konsumatorëve. Ne do të kemi mundësi të ofrojmë më shumë kanale alternative bankare, që ruajnë nivelet e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve tona si dhe optimizojnë vendimmarrjen e menaxhmentit. Gjatë vitit 2012, ne synojmë që, me gjithë ndryshimet në tregun bankar, ta bëjmë përvojën bankare më të lehtë, më të përshtatshme dhe më të pëlqyeshme.



BANKË PËR NJË BOTË NË LËVIZJE



“Gjëja më e bukur në këtë botë nuk është se ku jemi,
por në çfarë drejtimi po lëvizim”.

Oliver Wendell Holmes, Jr.







**MUSA ERDEN**

Kryesues i bordit të drejtorëve

I lindur në Hatay, Turqi, në vitin 1950, Musa Erden ka diplomuar në Akademinë e Shkencave Ekonomike, Komeriale dhe Bankare në Ankara. Ai e filloi karrierën e tij në "Yapi Kredi Bank" në vitin 1972. Pastaj kaloi në Bankën Osmanli në vitin 1973, ku mbajti poste të ndryshme deri në vitin 2001, duke përfshirë edhe atë të asistentit të menaxherit të përgjithshëm, zëvendës-drejtorit të përgjithshëm (BD / CM), dhe koordinorit. Ai shërbeu si anëtar i Komitetit të Arbitrazhit të Shoqatës së Bankave Turke nga viti 2002 deri 2003, dhe si drejtor i MNG Bankës në vitin 2003, si kryetar i katër kompanive të ndërtimit "Ottoman Structure Construction Tourism's" dhe si drejtor i "Ottoman Fund Ltd" ndërmjet 2006 dhe 2008-s. Ai u bashkua me TEB Group në vitin 2005 si Auditor i TEB A.Ş. dhe TEB investime financiare dhe ka shërbyer si konsulent nga viti 2006 deri në emërimin e tij të tanishëm si anëtar i Bordit Ekzekutiv të TEB A.Ş. në vitin 2008. Z. Erden u emërua kryesues i bordit të drejtorëve të TEB Sh.A në dhjetor të vitit 2010. Prej marsit 2011, ai është po ashtu ushtrues i detyrës së kryetarit të TEB Factoring dhe, nga viti 2010, anëtar i Bordit i BNP Paribas Leasing.

**İSMAİL YANIK, PhD**

Zëvendëskryetar i bordit të drejtorëve

U lind në Stamboll, Turqi, në vitin 1956. Pas diplomimit nga Departamenti i Inxhinierisë Industriale në Universitetin Teknik të Lindjes së Mesme (1979), İsmail Yanık përfundoi magjistraturën në inxhinieri industriale (1981) në universitetin Bogazici dhe Ph-në në Ekonomi (2007) në Universitetin e Stambollit. Dr. Yanık u diplomua në Programin e Menaxhimit të Avancuar në Universitetin e Harvardit (1999). Ai e filloi karrierën e tij në Pamuk Bankën në vitin 1980. Ai kaloi në Citibank NA në vitin 1984, ku mbajti poste të ndryshme deri në vitin 1992, duke përfshirë atë të asistentit të menaxherit të përgjithshëm, kontrolluesit financiar, menaxherit për "forfeit" dhe për produkte të strukturuar si dhe koordinorit të Citicorp Co International Trading, në Londër. Ai u bë pjesë e TEB A.Ş. në vitin 1992 si asistent i menaxherit të përgjithshëm dhe menaxher i thesarit të bankës. Ai u caktua si anëtar i Bordit Ekzekutiv në vitin 2002 dhe anëtar i Komitetit për Auditim në vitin 2005. Ai ka shërbyer gjithashtu si anëtar i Bordit të Forex Club të Turqisë, pastaj në Shoqatën e Menaxherëve të Rrezikut, TEB NV, TEB Investment Securities, si kryetar i TEB Precious Metals,

si zëvendëskryetar i Istanbul Gold Exchange, dhe si anëtar i Komitetit të Auditimit TEB NV. Nga 2007, Dr. Yanık ishte edhe ligjërues i pjesshëm në Departamentin Ekonomik të Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Stambollit. Ai është aktualisht këshilltar i Bordit të TEB A.Ş., anëtar i bordit të TEB CELETEM dhe zv/kryesues i BANTAS. Nga dhjetori 2007, Dr. Yanık është anëtar i bordit (zv/kryetar) dhe kryetar i Komitetit të ALM TEB Sh.A.

**AYŞE AŞARDAĞ**

Anëtare e bordit të drejtorëve

E lindur në Ankara, Turqi, në vitin 1964, Ayşe Asardag u diplomua në Universitetin Bogazici në vitin 1987 në Departamentin për Administrim të Biznesit. Ajo është kontabiliste e certifikuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabilistë të Anglisë dhe Uellsit, ACA në vitin 1992. Ajo e filloi karrierën e saj profesionale në Price Waterhouse dhe punoi në Njësinë e Auditimit në dy zyrat; Stamboll dhe Londër, në mes të viteve 1987-1994. Znj. Asardag ishte ligjëruese e Kontabilitetit në Universitetin e Glamorganit nga viti 1994 deri në vitin 1995. Në vitin 1995, ajo kaloi në sektorin e kontrollit financiar dhe të buxhetit në TEB deri në vitin 2001. Që atëherë ajo ka qenë udhëheqëse e sektorit financiar të TEB Holding. Znj. Asardag aktualisht

shërben edhe si anëtare e Bordit të TEB A.Ş., anëtare e Bordit dhe Komitetit të Auditimit në TEB NV, Anëtare e Bordit të TEB Factoring dhe anëtare e Bordit të Menaxhimit të aseteve në TEB. Ajo u emërua si zv/kryetare e TEB Sh.A në vitin 2007. Nga dhjetori 2007, Znj. Asardag është anëtare e Bordit dhe kryetare e Komitetit të Auditimit të TEB Sh.A.



DIDIER A.N. VAN HECKE
Anëtar i bordit të drejtorëve

I lindur në Bruksel, Belgjikë në vitin 1970, Didier Van Hecke diplomoi në Universitetin Katolik të Leuven-it në degën, Inxhinieri e Biznesit. Ai e filloi karrierën e tij profesionale si Menaxher stazhier në Generale Bank në vitin 1992. Ai shërbeu si analist i kredisë (Kredi të korporatave) nga viti 1993 deri në vitin 1996, si shef i analizës së kredisë (për korporata) nga 1996 deri në vitin 1999 në Generale Bank. Pas bashkimit të Fortis Bank, ai mbajti poste të ndryshme deri në vitin 2011, duke përfshirë atë të ndihmës-kryesuesit për analizën e kredive - Departamenti Qendror për Kredi, kryesuesit të Departamentit për Prejardhjen e Kredive, kryesues i prejardhjes së kredive tregtare, kryesues i rrezikut të huave (Fortis Azi)

dhe kryesues i rrezikut (Fortis AS Turqi). Ai kaloi në TEB A.Ş. si kryesues i rrezikut në vitin 2011. Deri në prill të vitit 2011, Z. Van Hecke është anëtar i Bordit dhe zv/kryetar i Komisionit të Auditimit në TEB Sh.A.



AKIL ÖZÇAY
Anëtar i bordit të drejtorëve

I lindur në Afyon, Turqi, në vitin 1959, Akil Ozçay ka diplomuar në Universitetin e Ankarasë në degën Administrim Biznesi dhe ka magjistruar në Universitetin Shtetëror në New Jersey në degën Ekonomi nga Rutgers. Ai e filloi karrierën e tij profesionale si asistent inspektor në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë në vitin 1981. Ai ka mbajtur poste të ndryshme në Bankën Qendrore të Republikës së Turqisë (CBRT) për 24 vjet, duke përfshirë Menaxher për Mbikëqyrje Bankare, Menaxher për Transaksione të jashtme dhe Këmbim, dhe Menaxher i Operacioneve të Tregut. Nga viti 2001 deri në vitin 2004 ai ishte drejtor i përgjithshëm i Departamentit CBRT për Tregje dhe nga viti 2004 deri në 2007, përfaqësuesi kryesor i CBRT-së në zyrën e përfaqësuesit në New York. Ai kaloi pastaj në Türk Ekonomi Bankası si këshilltari kryesor i menaxherit të përgjithshëm në vitin 2008. Nga viti 2011, është ndihmës menaxher i përgjithshëm i

të hyrave fikse në Turqi. Ai është edhe kryetar i Bordit për Menaxhimin e Aseteve të TEB-it dhe zv/kryetar i Bordit të Investimeve të TEB-it. Nga nëntori 2009, z. Ozçay ka qenë anëtar i Bordit dhe nga marsi 2010, anëtar i Komisionit të Auditimit në TEB Sh.A.



AYŞE KORKMAZ
Anëtare e bordit të drejtorëve

E lindur në Aydin të Turqisë në vitin 1973, Ayse Korkmaz diplomoi në Universitetin e Ankarasë, Fakulteti i Shkencave Politike, Departamenti i Administrimit të Biznesit. Ajo e filloi karrierën e saj profesionale si auditore e certifikuar bankare në Nënsekretariatit e Thesarit. Ajo shërbeu si auditore e certifikuar bankare në Agjencinë për rregullim dhe mbikëqyrje bankare nga viti 2000 deri në 2003. Ajo u bë pjesë e TEB Financial Investments A.Ş. në vitin 2003 si koordinatorë e auditimit. Ajo ishte caktuar si kryetare e Grupit të Pajtueshmërisë, Kontrollit të Brendshëm dhe Operacioneve të Rrezikut në vitin 2006. Nga prilli i vitit 2011, Znj. Korkmaz është anëtare e Bordit të TEB Sh.A.



ALP YILMAZ
Anëtar i bordit të drejtorëve
Kryesues Ekzekutiv (CEO)

I lindur në Stamboll, Turqi, në vitin 1965, Alp Yılmaz u diplomua në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Universitetin Dokuz Eylul, ndërsa magjistroi në Universitetin e Stambollit në Fakultetin e Shkencave Administrative (Administrim i Biznesit). Ai e filloi karrierën e tij profesionale në Bankën Turke për Zhvillim Industrial, si analist financiar në vitin 1991. Shërbeu si Auditor në Kocbank A.Ş. nga viti 1992 deri në vitin 1995. Në TEB A.Ş. kaloi në vitin 1997 dhe ka punuar në departamente të ndryshme, duke përfshirë atë të shitjes dhe marketingut, buxhetit dhe kontrollit financiar dhe menaxhimit të parasë. Në vitin 2007, Z. Yılmaz u emërua anëtar i Bordit dhe kryesues ekzekutiv i TEB Sh.A. Aktualisht është gjithashtu zv/kryetar i Odës Ekonomike Kosovaro-Turke, anëtar i Bordit të Odës së Tregtisë Kosovaro-Frënge dhe anëtar i Bordit të Shoqatës së bankierëve të Kosovës.

Bordi i Drejtorëve

